



RAPORT

Projekti për Zhvillim të Integruar Ekonomik Urban

Kuadri i Menaxhimit Mjedisor dhe Social

Përgatitur nga:

Dr. Zef PREÇI, Ekspert i Mbrojtjes Sociale
Prof. Dr. Seit SHALLARI, Ekspert i Mjedisit

Qershor 2016

LISTA E AKRONIMEVE

ACER	Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
DB	Ditët e Punës
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
HZHR	Hapësira për Zhvillim Rajonal
KB	Kombet e Bashkuara
KE	Komisioni Evropian
KEE	Komuniteti Ekonomik Evropian
KKTJ	Komiteti Kombëtar për Trashëgiminë Jomateriale
KMMS	Kuadri i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
KPZH	Kuadri i Politikave për Zhvendosje
KVA	Komiteti Vendor i Ankesave
MM	Ministria e Mjedisit
MOP	Manuali Operacional i Projektit
MSHA	Mekanizmi i Shqyrtimit të Ankesave
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
NJKP	Njësia Koordinuese e Projektit
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
PMM	Plani i Menaxhimit Mjedisor
PMMS	Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
PMO	Plani I Menaxhimit Operacional
PNP	Personat e Prekur nga Projekti

PVZH	Plani I Veprimit të Zhvendosjes
PVZHS	Plani i Veprimit i Zhvendosjes i Shkurtuar
PZHIEU	Projekti për Zhvillim të Integruar Ekonomik Urban
QSH	Qeveria e Shqipërisë
SKZHT	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Territorit
SMB	Strategjia për Menaxhimin e Bregdetit
UNKN	Unioni Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	Përshkrimi	7
2.	Përshkrimi i Projektit PZHIEU	7
2.1	Objektivat e Projektit	7
2.2	Përfituesit e Projektit dhe Komponentët e tij	8
2.3	Zona e propozuar e projektit	8
2.4	Qëllimi dhe Objektivat e KMMS-së	9
3.	Kuadri Ligjor dhe Rregullator për Vlerësimin Mjedisor	10
3.1	Hyrje	10
3.2	Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit	10
3.3	Ligji për Zonat e Mbrojtura	10
3.4	Ligji për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor	11
3.5	Ligje dhe rregullore në fushën e trashëgimisë kulturore	13
3.6	Direktiva e BE-së për VNM-në	15
3.7	Konventa Espoo	15
3.8	Krahasimi i Politikave të Bankës Botërore dhe Ligjit Shqiptar	16
4.	Kuadri Rregullator dhe Ligjor i Ndikimeve Sociale	17
4.1	Juridiksioni i Kuadrit	17
4.2	Kuadri Ligjor i Pronësisë dhe Kriteret e Vlerësimit të Pronësisë	17
4.3	Kriteret Ligjore për Vlerësimin dhe Kompensimin e Pronës	20
4.4	Kriteret e Bankës Botërore për Përcaktimin e së Drejtës për Kompensim	21
4.5	Hapësirat midis Legjislacionit Shqiptar dhe Politikave të Bankës Botërore	23
5.	Aspektet e Përgjithshme Mjedisore në Jugun e Shqipërisë	24
5.1	Përmbajtja	24
5.2	Biodiversiteti i Zonës	27
5.3	Zonat e Mbrojtura	28
6.	Procedura dhe udhëzime për të adresuar çështjet mjedisore dhe sociale të projektit	28
6.1	Parime orientuese dhe përqsja kryesore	28
6.2	Procesi i Shqyrtimit dhe Ndikimet Mjedisore	29
6.2.1.	Shqyrtimi dhe Studimi	29
6.2.2	Ndjeshmëria e mjedisit	30
6.2.3	Përcaktimi i kategorisë së aktiviteteve të projektit	30
6.2.4	Menaxhimi i Efekteve Mjedisore, procedura dhe udhëzime	31
6.3	Procesi i Shqyrtimit Social dhe Procedurat dhe Udhëzimet për Menaxhimin e Ndikimeve	33
6.3.1	Parimet e Menaxhimit Social të Projektit	33
6.3.2	Procesi i Shqyrtimit në Përvetësimin e Tokës dhe Zhvendosjen	35
6.3.3	Kategoritë e Mundshme të Ndikimeve Sociale	37
6.3.4	Kushtet që duhen ndjekur në Procedurën e Zhvendosjes	38
7	Kuadri dhe Marrëveshjet Institucionale	39
7.1	Kuadri Institucional i Mjedisit	Error! Bookmark not defined.
7.2	Marrëveshjet institucionale për shpronësim dhe kompensim në zbatimin procesit	41
7.3	Plani për Ngritjen e Kapaciteteve dhe Trajnimet	41
8	Procesi i Konsultimeve për KMMS-në dhe PZHEUI-në	42
8.1	Procesi i Konsultimeve për KMMS-në	43
8.2	Konsultimet me Popullsinë e Prekur	43
8.2.1	Mekanizmat për Konsultimet	43

8.2.2	Mekanizmi i Shqyrtimit të Ankesave	44
9	Marrëveshjet për monitorimin dhe vlerësimin mjedisor dhe social të projektit	46
9.1	Monitorimi i Brendshëm	46
9.2	Vlerësimi dhe Monitorimi i Jashtëm	46
	Anekset	48
	Aneksi 1. Komponentët dhe nën-komponentët e PZHIEU-së	48
	Aneksi 2. Termat e Referencës për KMMS (Version Origjinal)	50
	Aneksi 3. Përshkrimi i Zonave të Mundshme të Projektit	51
A.	Përshkrimi i qendrave urbane që do të përfitojnë nga implementimi i aktiviteteve të integruara urbane të projektit	51
3.1.	Gjirokastra “Qyteti i gurtë” (40°04’33”V; 20°08’20”L)	51
3.2.	Berati “Qyteti i një mijë dritareve”	53
3.3.	Përmeti (40°14’0”V, 20°21’0”L)	54
3.4.	Saranda, porta e turizmit shqiptar (39°52’30”V, 20°0’36”L)	55
3.5.	Ksamili (39°46’0”V, 20°0’0”L)	55
3.6.	Butrinti (39°44’46”v, 20°1’13”l)	56
B.	Zonat turistike para-përzgjedhura që do të përfitojnë nga aktivitetet e zbatimit të projektit.	57
3.7.	Laguna e Nartës (40°29’57”N, 19°27’26”E)	57
3.8.	Orikumi	59
3.9.	Gadishulli i Karaburunit	59
3.10.	Nga Karaburuni në Dhërmi	61
3.11.	Nga fshati i Dhërmiut në Porto Palermo	61
3.12.	Nga Kepi i Qeparoit në Kepin e Qefalisë	61
3.13.	Nga Kepi i Qefalisë në Kepin e Stillos	62
3.14.	Syri i Kaltër (39°55’25”V, 20°11’34”L)	62
	Aneksi 4. Plani i Përgjithshëm Mjedisor i Lehtësimit	Error! Bookmark not defined.
	Aneksi 5. Plani i Monitorimit Mjedisor	Error! Bookmark not defined.
	Aneksi 6. Procesi i Shqyrtimit Social	63
	Aneksi 7. Hapat kryesorë në Përgatitjen e Planit të Veprimit për Zhvendosje	74
	Aneksi 8. Skema dhe Përmbajtja e Mundshme për PVZH/PVZSH	75
8.1.	Përmbajtje për Planin e Veprimit për Zhvendosje	75
8.2.	Përmbajtje për Planin e Veprimit për Zhvendosje të Shkurtuar	78
	Aneksi 9. Lidhja e Zhvendosjes me Aktivitetet Specifike të PIUED-it	80
	Aneksi 10. Procedurat në Kuadrin e Zbatimit të PVZH-së	81
10.1.	Njoftimi, Procedurat e Vlerësimit dhe të Drejtat	81
	Procedurat për pagesën e kompensimit	83
10.2.	Implikimet Buxhetore dhe Financimi	84
	Aneksi 11. Rregullimet Institucionale për Zbatimin e Zhvendosjes dhe /ose Procedurës së Marrjes së Tokës	85
	Aneksi 12. Konsultimi Publik për KMMS-në – Minutat e Takimit	88
	Aneksi 13. Indikatorët e Propozuar të Planit të Monitorimit Social	93

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Konventat dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria.....	13
Tabela 2. Ligjet e adoptuara pas ratifikimit të konventave ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë.....	14
Tabela 3. Kategoritë e Humbjes së Pronës	18
Tabela 4. Tabela e Hapësirave midis Legjislacionit Shqiptar dhe Politikave të Bankës Botërore.....	23
Tabela 5. Zonat e Mbrojtura në Rajon	28
Tabela 6. Komponentët e projektit, aktivitetet e mundshme dhe ndikimi i tyre.....	30
Tabela 7. Kategoritë e humbjeve dhe ndikimet e tyre mbi personat e prekur nga projekti	37
Tabela 8. Tipologjitë e Përgjithshme të Grupeve të Prekura nga Projekti.....	38
Tabela 9. Ligje dhe agjenci zbatuese	39
Tabela 10. Plani i Propozuar i Ndërtimit të Kapaciteteve	42

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Harta e Shqipërisë sipas Sesionit Hartografik të OKB.....	26
Figura 2. Vlerësimi i Rëndësisë së Ndikimit Bazuar në Nivelin e Madhësisë dhe Ndjeshmërinë Mjedisore	Error! Bookmark not defined.

1. Përshkrimi

Qeveria e Shqipërisë (QSH) është duke zbatuar një program reformues ambicioz me qëllim përshpejtimin e rritjes ekonomike, krijimin e vendeve të punës, forcimin e besimit tek qeverisja dhe përparim në procesin e integritimit Evropian. Pjesë e kësaj përpjekje e QSH^{së} është avancimi drejt një përqsaje për zhvillimin rajonal. Projekt Ligji për Zhvillimin Rajonal është në fazën e fundit të miratimit dhe ka për qëllim të krijojë katër Hapësira për Zhvillimin Rajonal (HZHR) dhe Agjenci të Posaçme për Zhvillimin e Rajoneve.

Kjo reformë ka për qëllim të arrijë (i) efekte të dukshme përmes një përqsaje të integruar dhe harmonizimit të programeve në një territor të caktuar, (ii) forcimin e kohezionit për zhvillimin e territorit përmes zbatimit të strategjive të zhvillimit rajonal dhe në një afat të mesëm (iii) krijimin e kapaciteteve për përfitimin dhe përdorimin e Fondeve Strukturore të BE dhe financime të tjera. Kjo reformë është në hapat e para së bashku me proceset e tjera që nevojiten për zhvillim në nivel rajonal.

Qeveria e Shqipërisë gjatë viteve të mëparshme nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban (MZHU) ka zhvilluar instrumenta strategjikë me rëndësi për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar duke përfshirë Jugun e Shqipërisë.

MZHU sapo ka përfunduar përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Territorit (SKZHT) dhe Strategjinë për Menaxhimin e Bregdetit (SMB). Këto dokumenta strategjikë (SKZHT, SMB) demonstrojnë një vizion të shëndetshëm dhe një drejtim strategjik për zhvillimin e vendit për 15 vitet në vazhdim (2015-2030). Për këto dy strategji zhvillimi është bërë Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Ministria e Mjedisit ka aprovuar Deklaratën Mjedisore në 9.05.2016.¹

Në kontekstin e reformës territoriale dhe me rritjen e konkureshmërisë për fonde, në hapësirat e reja fiskale, QSH^{ja} ka vendosur që Banka Botërore të fokusohet dhe të mbështesë Jugun e Shqipërisë në kuadër të Projektit i Zhvillimit të Integruar Ekonomik dhe Urban (PZHIEU).

Ky rajon është konsideruar prioritet për shkak të pasurive natyrore dhe vlerave kulturore, presionit të zhvillimit i cili mund të ndikojë negativisht territorin nëqoftëse planifikimi i qëndrueshëm urban nuk merr në konsideratë aspektet sociale dhe mjedisore. Projekt propozimi është parë si një mundësi për të demonstruar vlerën e një përqsaje të integruar në nivel rajonal, veçanërisht me synimin e nxitjes së potencialit të kapitalit të sektorit privat.

PZHIEU^{ja} pritet të luajë një rol të rëndësishëm dhe demonstrojë një përqsaje të integruar inovative për zhvillimin rajonal në harmoni me SKZHT^{në} e re dhe SMB^{në}.

2. Përshkrimi i Projektit PZHIEU

2.1 Objektivat e Projektit

Projekti i propozuar PZHIEU-së do të jetë një katalizator për zhvillimin rajonal në jug të Shqipërisë, duke nxitur përfitimin e fondeve nga partnerët e tjerë të zhvillimit dhe Fondi i Zhvillimit Rajonal. Projekti do të mbështesë vizionin e Qeverisë Shqiptare për të promovuar

¹ <http://www.mjedisi.gov.al/dokumenta/vleresimi-strategjik-mjedisor-vsm>

zhvillimin rajonal duke përmirësuar infrastrukturën urbane, rritjen e vlerave kulturore dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për të mbështetur zhvillimin ekonomik lokal në zonat e përzgjedhura në jug të Shqipërisë.

Projekti do të ofrojë një model për replikim në rajone të tjera për të përdorur një qasje të integruar për të nxitur ndihmat dhe sektorët konkurrues për një rritje të qëndrueshme ekonomike. Duke pasur parasysh se SKZHT-ja dhe SMB-ja kanë identifikuar turizmin dhe kulturën (turizmit i bazuar në kulturë) si një nga drejtimet kryesore të zhvillimit ekonomik në jug të Shqipërisë, projekti pritet të financojë aktivitetet që kanë për qëllim promovimin e zhvillimit të një ekonomie lokale të qëndrueshme, konkurruese dhe të larmishme duke vënë në dukje potencialin e njohur të sektorit të turizmit.

2.2 Përfituesit e Projektit dhe Komponentët e tij

Përfituesit kryesorë të projektit të propozuar janë banorët në komunat e përzgjedhura (Berat, Gjirokastrë, Sarandë dhe Përmet) dhe vizitorët në jug të Shqipërisë, të cilët do të përfitojnë në mënyrë direkte nga shërbimet e përmirësuara të infrastrukturës urbane dhe ofertat e përmirësuara turistike. Banorët e bashkive të përzgjedhura pritet gjithashtu të përfitojnë nga rritja e mundësive ekonomike. Komunat e përzgjedhura janë bazë për rreth 84,000 banorë rezident dhe Jugu i Shqipërisë, si një i tërë vizitohet - në baza vjetore - nga rreth 527,000 turistë². Qeveria pritet të përfitojë nga rritja e shpenzimeve të turizmit në përgjithësi, krijimi i vendeve të punës, cilësia e përmirësuar institucionale e komunave dhe agjencive qeveritare të zgjedhura, dhe përmirësimi i kapaciteteve për të vepruar dhe për të ruajtur pasuritë. Projekti i propozuar do të përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:

Komponenti 1. Përmirësimi urban dhe përmirësimi i infrastrukturës (50 milion \$ amerikan).

Nënkomponenti 1A: Përmirësimi i integruar urban dhe i qytetit.

Nënkomponenti 1B: Përmirësimi i integruar i pikave satelitore.

Komponenti 2. Ngritja e kapaciteteve institucionale (8 milionë \$ amerikan).

Nënkomponenti 2A: Ndërtimi i kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve bashkiake

Nënkomponenti 2B: Ndërtimi i kapaciteteve për rritjen e qëndrueshme të turizmit

Komponenti 3: Mbështetja në zbatim (2 milion \$ amerikan).

Një përshkrim i detajuar i komponentëve mund të gjendet në Aneksin 1.

2.3 Zona e propozuar e projektit

Projekti i propozuar pritet të përqendrohet në jug të Shqipërisë, që përfshin zonën ndërmjet Vlorës dhe Sarandës dhe mbulon edhe zonën bregdetare ashtu edhe pjesën e brendshme të zonës jugore (përfshirë Berat, Përmet dhe Gjirokastrë). Kjo zonë është te përmendur në SMB-në për turizmin e saj dhe potencialin kulturor të zhvillimit ekonomik.

Projekti i propozuar pritet të mbështesë *qendrat urbane parësore dhe të specializuara* - siç është përcaktuar në SMB dhe SKZHT - në Jug të Shqipërisë dhe zonave për rreth tyre. Investimet pritet të përqendrohen në përmirësimin e infrastrukturës urbane në zonat e

²Sistemi i statistikave të turizmit kombëtar nuk është i zhvilluar mirë dhe nuk përfshin statistikat nën-kombëtare apo rajonale. Vlerësimet janë bazuar në pjesën e turistëve që mendohet të kenë vizituar Jugun e Shqipërisë duke përdorur shënimet e hyrjes në monumentet kulturore në këtë zonë, si një baye karahasimi.

përzgjedhura urbane në jug të Shqipërisë dhe në rritjen e trashëgimisë së zgjedhur kulturore dhe pikat turistike përgjatë korridoreve lidhëse.

2.4 Qëllimi dhe Objektivat e KMMS-së

Duke qenë se vlerësimi teknik (p.sh., studimet e fizibilitetit, dizajnet e hollësishme) dhe ndërhyrjet në vende të veçanta në kuadër të projektit nuk do të identifikohen plotësisht dhe ndikimet e tyre specifike nuk do të jenë të njohura në vlerësimin e projektit, përgatitja e këtij KMMS-je, së bashku më përmbajtjen e Kuadrit të Politikave për Zhvendosje (KPZH) përshkruan procedurat e përgjithshme mbrojtëse të mjedisit dhe ato sociale që duhen ndërmarrë gjatë zbatimit të projektit. Prandaj, qëllimi i këtij KMMS-je është të jetë një udhëzues për Procesin e Vlerësimit Mjedisor dhe Social të rëndësishëm për aktivitetet e propozuara të projektit. Ai shërben si për të menaxhuar ndikimet e mundshme negative të projektit në përputhje me Politikën Operative të Bankës O.P. 4.01 *Për Vlerësimin Mjedisor* dhe ligjet përkatëse kombëtare, ashtu edhe për të përcaktuar trajtuar dhe menaxhuar procesin se si vlerësohen ndikimet sociale dhe të mjedisit, për aktivitetet e projektit. Aktivitetet fillestare të projektit janë identifikuar për vitin e parë dhe janë të mbështetura nga instrumentet specifike të mbrojtjes (KMMS). Më tej, KMMS-ja përfshin një sërë masash monitoruese dhe zbutëse, ashtu edhe përgjegjësitë institucionale që do të merren gjatë zbatimit të projektit.

Përveç kësaj KMMS-ja mbulon masat e përgjithshme zbutëse për ndikimet e mundshme të aktiviteteve të ndryshme të propozuara për t'u mbështetur nga projekti; marrëveshjet e zbatimit për aspektet mjedisore dhe sociale të projektit, aktivitete të rëndësishme për ngritjen e kapaciteteve, procesin e konsultimit etj

Ky KMMS është dokumenti i fokusuar në zbatimin e përgjithshëm të projektit. KMMS-të specifike për investime të identifikuar gjatë zbatimit të projektit, do të jenë të përgatitura në kohën e duhur para se të fillojnë punimet. Informacioni i KPZH-së, pjesë e këtij KMMS, shërben për të vlerësuar dhe për të zbutur ndikimet e mundshme sociale që lidhen me zhvendosjen fizike ose ekonomike të popullsisë të kërkuar nga projektin.

Së fundi, ky KMMS do të jetë një pjesë integrale e Manualit Operacional të Projektit (MOP) dhe është i lidhur me të gjitha investimet e financuara në zonat e projektit, pavarësisht nga burimi i tyre i financimit apo agjencisë zbatuese.

3. Kuadri Ligjor dhe Rregullator për Vlerësimin Mjedisor

3.1 Hyrje

Kushtetuta e Shqipërisë e cila është ratifikuar nga Parlamenti në vitin 1998 sanksionon të drejtën për një mjedis të shëndetshëm si një detyrim institucional për brezat e sotëm e të ardhshëm. Gjatë dekadës së fundit dhe veçanërisht pas viteve 2001, janë hartuar dhe aprovuar një numër i konsiderueshëm ligjesh e aktesh ligjore në fushën e mjedisit.

Kuadri ligjor në nivel nacional kryesisht është harmonizuar me atë të BE-së. Në Shqipëri, kuadri ligjor që lidhet me mjedisin dhe çështjet social ekonomike bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe përbëhet nga ligje dhe akte rregullative nënligjore, si p.sh. Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM), akte në nivel ministrie, rregullore, udhëzime dhe standarde.

3.2 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit

Kuadri ligjor në fushën e mjedisit kryesohet nga ligji “Për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 10431, datë 06.06.2011³. Ky ligj përcakton parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit duke përdorur Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si një instrument për mbrojtjen e mjedisit duke identifikuar dhe vlerësuar efektet e mundshme direkte dhe indirekte dhe parandalimin e tyre.

Në nenin 6 të ligjit përcaktohet parimi i zhvillimit të qëndrueshëm ku thuhet: ”autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve brenda kompetencave të tyre, nxitin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke përdorur burimet natyrore në atë mënyrë që të plotësohen nevojat aktuale dhe të ruhet mjedisi, pa cenuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre”.

Ligji mundëson politika kombëtare dhe lokale për mbrojtjen e mjedisit, kërkesat për përgatitjen e vlerësimit të ndikimeve mjedisore dhe e vlerësimit të strategjisë mjedisore, kërkesat për aprovimin ose lejimin e aktiviteteve që ndikojnë mjedisin, parandalimin dhe reduktimin e ndotjes mjedisore, normat mjedisore dhe standardet, monitorimin dhe kontrollin e mjedisit, detyrat e institucioneve shtetërore në lidhje me problematikën mjedisore, rolin e publikut, sanksionet dhe penalitetet në rast të shkeljes së ligjit.

3.3 Ligji për Zonat e Mbrojtura

Ligji nr. 8906, date 06.06.2002 “për Zonat e Mbrojtura” ka krijuar kornizën e nevojshme për shpalljen, administrimin, menaxhimin e përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe burimeve biotike natyrore.

Ligji ka hedhur bazat për zhvillimin dhe përmirësimin e “turizmit mjedisor” dhe përfitime të tjera ekonomike si dhe ofrimin e informacionit dhe edukimin e publikut të gjerë. Objektivi parësor i ligjit është të ofrojë mbrojtje të veçantë për rezervat natyrore, biodiversitetin dhe natyrën në përgjithësi, përmes krijimit të rrjetit të zonave të mbrojtura bazuar në kategoritë e

³Ky ligj është i përafuar me Direktivën 2004/35/CE e Parlamentit dhe Këshillit e dates 21Prill 2004 për detyrimet mjedisore referuar parandalimit dhe korrigjimit të demtimit të mjedisit. Fletorja Zyrtare 143, 30/04/2004 P. 0056-0075

sistemit të Unionit Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës (UNKN)⁴. Për më shumë ligji përcakton prioritetet dhe objektivat strategjik për menaxhimin e çdo kategorie të zonave të mbrojtura.

Zonat e mbrojtura në Shqipëri janë konsideruar kryesisht hapësirat pyjore të cilat kanë qenë të administruara nga ish Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave nën sistemin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Pyjeve. Mbas hyrjes në fuqi të ligjit nr 8906 /2002 “për zonat e mbrojtura” Ministria e Mjedisit merr rolin kryesor për zonat e mbrojtura në Shqipëri dhe është përgjegjëse për:

- Propozimet për zonat që duhet të vendosen në mbrojtje.
- Përgatitja e procedurave ligjore dhe menaxheriale për propozimin dhe deklarinimin e zonave të mbrojtura.
- Hartimi i planeve për menaxhimin e zonave të mbrojtura.
- Menaxhimin dhe monitorimin në vazhdimësi.

Sipas ligjit për zonat e mbrojtura rolin primar e luan Ministria e Mjedisit, Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave dhe ministri të tjera. Zonat e mbrojtura në Shqipëri përfshijnë 15 Parqe Kombëtare, 5 Peisazhe të Mbrojtura, 4 Rezervate Strikte Natyrore, 26 Rezerva Natyrore të Menaxhuara dhe kategori të tjera.

Shumica e zonave të mbrojtura janë pajisur me sinjalistikë dhe gradualisht me qendra informacioni⁵. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 102, date 04.02.2015 dhe synon mbrojtjen, menaxhimin, zhvillimin dhe zgjerimin e sipërfaqes së mbrojtur e cila aktualisht arrin në 16% e territorit të Shqipërisë. AKZM menaxhon rrjetin e zonave të mbrojtura dhe rrjete të tjera si Natyra 2000.

3.4 Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Ligji i ri “për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 10 440, date 7.07. 2011 është përafuar me Direktivën 85/337/EEC datë 27 Korrik 1985 për vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin⁶.

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet parandalimit, zbutjes dhe kompensimit të dëmeve të projekt propozimit i cili mund të shkaktojë efekte negative të rëndësishme direkte ose indirekte mbi mjedisin për shkak të madhësisë, natyrës ose zonës ku parashikohet të zbatohet.

Ligji përcakton rregulla për vlerësimin e efekteve mjedisore, palët e përfshira dhe detyrimet e autoriteteve për të bërë të aksesueshëm informacionin dhe qëndrimin ndaj raportit të VNM-së për zhvilluesin. Një vëmendje e posaçme i kushtohet zonave të mbrojtura ku nuk lejohet zhvillimi i projekteve me përjashtim të disa rasteve të veçanta. Gjithashtu, trajtimi i efekteve ndërkufitare janë pjesë e këtij ligji.

⁴ UNKN/ Kategoritë e Menaxhimit për Zonat e Mbrojtura

⁵ https://en.wikipedia.org/wiki/Protected_areas_of_Albania

⁶ Ligji Nr 10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimeve Mjedisore“

Ligji për VNM-në përcakton tipin e VNM-së që kërkohet për një projekt para zbatimit. Sipas ligjit parashikohen dy nivele të VNM-së për projektet (i) VNM paraprake dhe (ii) dhe VNM e thelluar.

- VNM-ja paraprake. Kjo formë është për projektet me efekte të mundshme në shkallë më të ulët të parashikuara në Aneksin 2 të ligjit për VNM-në.
- VNM-ja e thelluar. Kjo është për projektet me efekte të rëndësishme, të listuara në aneksin 1 të ligjit si dhe projektet e aneksit 2 për të cilët ministria vlerëson se kanë ndikime të rëndësishme mbi mjedisin (përfshirë aktivitete që do të zhvillohen në zonat e mbrojtura). Procedura e VNM-së së thelluar përfshin debatin publik dhe autoritetet e përfshira në proces.

Më poshtë renditen ligjet kryesore që lidhen me mbrojtjen dhe vlerësimin e mjedisit:

- Ligji Nr. 10119/09 "për planifikimin e territorit", ndryshuar me ligjin Nr. 10258, date 21.04.2010 dhe ligjin Nr. 10315 date 16.09.2010;
- Ligji Nr. 9700, date 26.03.2007 "për mbrojtjen e mjedisit nga efektet ndërkufitare";
- Ligji Nr. 9478, date 16.02.2006 "për aderimin e Republikës së Shqipërisë në vendimet II/14 dhe III/7, amendamentet e Konventës Espoo për VNM-në në kontekstin ndërkufitar;
- Ligji Nr. 8897, date 16.05.2002 "për mbrojtjen e ajrit" ndryshuar me ligjin Nr. 10266, date 15.04.2010;
- Ligji Nr. 9424, date 06.10.2005 "për ratifikimin e protokollit të vlerësimit strategjik mjedisor";
- Ligji Nr. 9010, date 13.2.2003 "për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta" ndryshuar me ligjin Nr. 10137, date 11.05.2009.
- Ligji Nr. 9115, date 24.07.2003 "për administrimin e ujërave të ndotura" (ndryshuar me ligjin Nr. 10448/11 "Për Lejet Mjedisore"
- Ligji Nr. 8906, date 06.06.2002 "për zonat e mbrojtura", ndryshuar me Ligjin Nr. 9868, date 04.02.2008;
- Ligji Nr. 10463, date 22.09.2011 "për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
- Ligji Nr. 9048, date 07.04.2003 "për trashëgiminë kulturore;" ndryshuar me ligjin Nr. 9592, date 27.07.2006;
- Ligji Nr. 9882, date 28.02.2008; dhe ligjin Nr. 10137, date 11.05.2009 "për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për liçensat, lejet dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë;"
- VKM Nr. 676, date 20.12.2002 "për deklarimin e monumenteve të natyrës shqiptare si zona të mbrojtura;"
- Ligji Nr. 8756, date 26.03.2001 "për emergjencat civile" ndryshuar me ligjin Nr. 10137, date 11.05.2009 "për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për liçensat, lejet dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë;"
- Ligji Nr. 8093, date 21.03.1996 "për rezervat ujore" ndryshuar me ligjin Nr. 8375 date 15.07.1998;
- Ligji Nr. 8905, date 06.06.2002 "për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmet".

Përveç kuadrit ligjor Shqiptar procesi i VNM-së respekton detyrimet ndërkombëtare të parashikuara nga konventat dhe marrëveshjet e ratifikuara nga Shqipëria.

Tabela e mëposhtme tregon konventat dhe marrëveshjet të cilat janë të lidhura me mjedisin dhe që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë ndër vite.

Tabela 1. Konventat dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria

Emri i konventës	Koha e ratifikimit
Konventa Ramsar për ligatinat (1971)	29/02/1996
Konventa për biodiversitetin	pjesërisht nga 1994; pjesë të protokollit nga 2005
Konventa e Bernës për Ruajtjen e Jetës së Egër dhe Habitave Natyrore në Evropë. (1976)	13/01/1999
Konventa e UNESCO për mbrojtjen e Kulturës Botërore dhe Trashëgimisë Kulturore. (2003)	10/07/1989
Konventa kuadër e OKB për ndryshimet klimatike (UNFCCC)	01/12/1994
Konventa e Aarhus (1998), në vendimmarrje dhe e drejta për t'ju drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore	27/06/2001
Konventa e Bonn (1979); për ruajtjen e specieve migratore dhe kafshët e egra	01/09/2001
Konventa e Barcelonës (1976); për mbrojtjen e Detit të Mesdheut nga ndotja	09/07/2004
Protokolli i Kyoto-s	01/04/2005
Konventa e UNESCO për ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (2003)	04/04/2006
Konventa Espoo: për VNM-në në kontekstin ndërkufitar së bashku me amendimet e protokollit (1991)	12/05/2006
Konventa për mbrojtjen e pasurive të trashëgimisë kulturore nënujore (2001)	19/03/2009

Burimi: MM, 2016

3.5 Ligje dhe rregullore në fushën e trashëgimisë kulturore

Projektet për të gjitha ndërtimet mbi e nëntokë dhe projektet për infrastrukturën inxhinierike në të gjithë vendin bazohen në standarde dhe kërkesat ligjore të akteve në fuqi.

Ligji Nr. 10119/09 "për planifikimin e territorit", ndryshuar me ligjin Nr. 10258, date 21.04.2010 dhe Ligjin Nr. 10315 datë 16.09.2010, është rregullatori kryesor ligjor në Shqipëri që lidhet me planifikimin urban dhe synon të përfshijë kuadrin ligjor të planifikimit urban në një ligj të vetëm.

Ligji Nr. 10119/09 ka hyrë në fuqi në 30 Shtator 2011. Qëllimi kryesor i këtij ligji është të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm të territorit nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe burimeve natyrore. Ky ligj përfshin konceptet e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore, mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë të komunitetit. Përveç kësaj, ligji përmend instrumente të integruara të planifikimit të përdorshme për zonat bregdetare, për trashëgiminë kulturore, natyrore dhe peizazheve, si dhe për fusha të tjera me rëndësi ose interes të përbashkët.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore në Shqipëri trajtohet nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe disa institucione të specializuara në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Në kuadër të Ministrisë, Departamenti i Trashëgimisë Kulturore mbikëqyr Institutin e Monumenteve, nëntë Muzetë Kombëtare, dhe Qendrën e Regjistrimit të Pasurisë Kulturore. Trashëgimia kulturore përfshin: vendet arkeologjike, ndërtesat historike (të izoluara dhe në rrethe), varrezat dhe vendet e investuara në kuptimin tradicional me natyrë historike, kulturore ose fetare.

Ligji 9048 ("Akti për Trashëgiminë Kulturore") i miratuar më 7 prill, 2003 (ndryshuar me ligjin nr 9592, datë 27.07.2006; Ligjin nr 9882, datë 28.02.2008) është kuadri kryesor ligjor që rregullon menaxhimin e pasurive kulturore materiale dhe jomateriale në Shqipëri.

Ligji 9048 përfaqëson përpjekjen e parë për të zgjeruar mbrojtjen ligjore në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale. Këtu përfshihen: kategoritë e trashëgimisë kulturore shqiptare për tu mbrojtur (p.sh. të prekshme, të paprekshme, të luajtshme, të paluajtshme); përkufizime dhe shembuj të trashëgimisë materiale dhe jomateriale; përgjegjësitë e institucioneve përkatëse dhe organeve të pushtetit; dënimet për ata që dëmtojnë trashëgiminë kulturore; dhe procedurat lehtësuese.

Neni 4 liston pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme për t'u mbrojtur por nuk kufizohen vetëm në: vendet arkeologjike; struktura historike (duke përfshirë vendet e adhurimit); qytetet dhe lagjet historike; varrezat dhe varre dhe peizazhet historike.

Ligji 9048 është ndryshuar me ligjin 9592, datë 2006/07/27. Ndryshimet përfshinin 1) futjen e Komitetit Kombëtar të Trashëgimisë Kombëtare si organ këshillues dhe 2) krijimin e Komitetit Kombëtar për Trashëgiminë Jomateriale (KKTJ). Ligji 9048 u ndryshua përsëri me ligjin nr 9882, datë 28.02.2008. Ndryshimet e vitit 2008 përfshinë nene për rindërtimin e rrjetit të institucioneve të specializuara të trashëgimisë kulturore dhe nene që kanë të bëjnë me krijimin e Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë dhe institucioneve të specializuara të tilla si Shërbimi Arkeologjik Shqiptar.

Sipas ligjit, nëse diçka e pazakontë do të gjenden gjatë procesit të gërmimeve, puna duhet të ndalojë menjëherë, urgjentisht duhet të informohen autoritetet lokale, Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe Ministrinë e Kulturës. Ata do të dërgojë arkeologë dhe specialistë të fushës në terren për të kontrolluar dhe për të vlerësuar objektet e supozuara arkeologjike dhe punimet do të rifillojnë vetëm pas lejes zyrtare të dhënë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Gjithashtu, Shqipëria respekton detyrimet ndërkombëtare të parashikuara nga konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria në kuadër të trashëgimisë kulturore.

Tabela 2. Ligjet e adoptuara pas ratifikimit të konventave ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë

Emri i konventës	Viti i ratifikimit
Ligji nr. 9490, datë 13.03.2006 "Për ratifikimin e Konventës për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale", Paris 2003	2006
Ligji nr. 9806, datë 17.09.2007 "Për ratifikimin e Konventës Evropiane "Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike"	2007
Ligji Nr 10 027, datë 11.12.2008 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore", Paris 2001	2008

Burimi: <http://www.kultura.gov.al/al/baza-ligjore>

3.6 Direktiva e BE-së për VNM-në

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) u zyrtarizua në Evropë në vitin 1985 me Direktivën për VNM-në (85/337 / EEC) dhe përfaqëson një instrument kyç për politikën mjedisore të Bashkimit Evropian⁷.

Direktiva për VNM e vitit 1985 është ndryshuar tre herë:

- Direktiva 97/11 / KE e bën direktivën e VNM në përputhje me Konventën Espoo të ECE OKB-së për VNM-në në një kontekst ndërkufitar. Direktiva e vitit 1997 e zgjeron fokusin duke rritur llojet dhe numrin e projekteve që kërkojnë vlerësim të detyrueshëm të ndikimit në mjedis. Janë përcaktuar kritere të reja për shqyrtimin e projekteve dhe minimumin e informacionit të nevojshëm;
- Direktiva 2003/35 / KE përfshin ndryshime që lidhen me Konventën e Aarhusit për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe të drejtën për t'ju drejtuar organeve të drejtësisë për çështjet mjedisore;
- Direktiva 2009/31 / KE ndryshon Aneksin I dhe II të Direktivës për VNM-në, duke shtuar projekte në fushën e transportit, kapjen dhe ruajtjen e dioksidit të karbonit (CO₂).

Më 28 janar 2012, Direktiva 2011/92 / BE “mbi efektet e projekteve publike dhe private mbi mjedisin” është publikuar në Fletoren Zyrtare. Direktiva 2011/92 / BE kodifikon Direktivën e Këshillit 85/337 / EEC mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin (Direktiva EIA) me ndryshimet e bëra. Direktiva 2011/92 / EU ruan plotësisht përmbajtja e akteve të kodifikuara duke i prezantuar së bashku me ndryshimet formale siç kërkohet nga vetë ushtrimi kodifikimit.

Qëllimi i kësaj direktive është të sigurojë që planet, programet dhe projektet që mund të ketë efekte të rëndësishme në mjedis të nënshtrohen Vlerësimit Mjedisor para miratimit ose autorizimit të tyre. Shtojca I përmban një listë të projekteve për të cilat VNM është e detyrueshme, Shtojca II përcakton ato kategori të projekteve për të cilat VNMS është fakultative dhe përcaktohet nga shtetet anëtare.

Më 16 prill 2014, Direktiva 2011/92 / EU mbi efektet e projekteve publike dhe private mbi mjedisin është ndryshuar nga Direktiva 2014/52 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për VNM-në.

3.7 Konventa Espoo

Konventa e OKB-së për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekstin ndërkufitar (Konventa Espoo e mbajtur në vitin 1991) përcakton detyrimet e vendeve që e kanë ratifikuar Konventën për të vlerësuar ndikimet ndërkufitare mjedisore të një projekti në fazën e hershme të planifikimit. Konventa e Espoo është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin nr 9478/2006⁸.

Procesi i njoftimit dhe konsultimit me palët e përfshira drejtohet nga autoriteti kompetent. Megjithatë, autoritetet mund të kërkojë nga zhvilluesi të përgatisin njoftimin dhe konsultimin publik përtej kërkesave të parashikuara nga procesi normal i VNM-së. Zhvilluesi mund të

⁷ <http://ec.europa.eu/environment/eia/eia-legalcontext.htm>

⁸ Fletprja Zyrtare - Nr. 20, 17 Mars, 2006, fq. 631.

ndërmarrë konsultime publike me palët e prekura. Procesi njoftimit dhe konsultimi në bazë të Konventës Espoo përbëhet nga elementet kryesorë të mëposhtëm:

- Njoftimi i vendeve të prekura nga projekti
- Përgatitja e dokumentacionit të vlerësimit të ndikimit në mjedis
- Konsultimi midis vendeve të përfshira
- Vendimi përfundimtar.

Në të gjitha fazat përfshihen procedura specifike të kërkuara nga Konventa. Projekti i propozuar PZHIEU është klasifikuar në kategorinë "B" dhe nuk parashikohet të ketë ndikime mjedisore ose sociale ndërkufitare.

3.8 Krahasimi i Politikave të Bankës Botërore dhe Ligjit Shqiptar

VNM-ja është një instrument i rëndësishëm për qendrueshmërinë mjedisore për agjencitë shumë palëshe të zhvillimit duke përfshirë Bankën Botërore. Banka adaptoi VNM-në si një politikë për mbrojtjen ligjore, sociale e mjedisore, nëpërmjet identifikimit parandalimit, zbutjes së ndikimeve të mundshme negative mjedisore që lidhen me operacionet e financuara nga banka.

Investimet parashikuara nga projekti pritet të kenë përfitime pozitive sociale dhe mjedisore. Projekti i nënshtrohet shqyrtimit në përputhje me politikat e mëposhtme të Bankës Botërore: për Vlerësimin Mjedisor (OP 4.01); për Habitatet Natyrore (OP 4.04); për Burimet Fizike dhe Kulture (OP 4.11); dhe Zhvendosjen Jovullnetare (OP 4.12).⁹

Politikat mjedisore në Shqipëri janë në përputhje me politikat mbrojtëse të Bankës Botërore (shih "*kuadri ligjor dhe rregullator për Vlerësimin Mjedisor*" më sipër). Për informacion të detajuar mbi këto politika të aplikueshme për projektin, ju lutem vizitoni faqen e internetit.¹⁰ Procedurat e VNM-së në Shqipëri janë përgjithësisht në përputhje me procesin e Vlerësimit Mjedisor që realizohet nga BB, si të gjithë projektet që kërkojnë një lloj shqyrtimi mjedisor ose vlerësimi në mënyrë që të merret një miratim mjedisor (për ndërtim), dhe / ose një leje mjedisore (për një aktivitet me ndikim në mjedis, duke përfshirë edhe aktivitete të ndërtimit). Për më tepër, lloji dhe shkalla e ndikimeve të projektit në mjedis do të përcaktojnë procedurat që duhen ndjekur dhe llojin e lejes mjedisore. Gjithashtu, të gjitha aprovimet përfshijnë kushte që do të zbatohen nga propozuesi, duke përfshirë monitorimin e mjedisit dhe masat zbutëse. Dallime mund të ketë për disa projekte që BB i klasifikon në kategorinë A ndërsa sipas ligjit Shqiptar ato përfshihen në aneksin 2.

⁹ Projekti gjithashtu shkakton politikën për Projektet për Sipërfaqet Ujore Ndërkombëtar (OP / BP 7.50). Është parashikuar që investimet e planifikuara nuk do të ndryshojnë negativisht në cilësinë apo sasinë e rrjedhave ujore ndaj bregoreve të tjera, dhe nuk do të ndikohen negativisht nga përdorimi i mundshëm i bregoreve të tjera të ujit. Kështu, ndërsa është shkaktuar politika, projekti kualifikohet në një përjashtim nga njoftimi 'nën par' i kërkesave të bregoreve 7 (a) të OP 7.50 dhe asnjë njoftim nuk do të jetë i nevojshëm. Projekti gjithashtu do të jetë në përputhje me Qasjen në Politikën e Informacionit.

¹⁰Për më shumë informacion vizitoni:

<http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/PROJECTS/EXTPOLICIES/EXTSAFEPOL/0,,menuPK:584441~pagePK:64168427~piPK:64168435~theSitePK:584435,00.html>

Disa projekte (p.sh. menaxhimi i ujërave të ndotura) klasifikon në kategorinë A sipas BB ndërkohë që sipas ligjit shqiptar kërkohet një VNM paraprake për popullsi më pak se 30.000, përveç rastit kur MM vendos që projekti duhet t'i nënshtrohen një VNM-je të thelluar. Megjithatë, projekti është vlerësuar i Kategorisë B, sipas BB OP 4.01. Për aktivitetet e projekteve që përfshihen në aneksin II të ligjit të VNM-së në Shqipëri kërkohet një VNM paraprake.

4. Kuadri Rregullator dhe Ligjor i Ndikimeve Sociale

4.1 Juridiksioni i Kuadrit

Në zbatimin e këtij kuadri, do të zbatohen elementët e mëposhtëm:

- a. Në rast të ndonjë hapësire ose mospërputhjeje ndërmjet kuadrit ligjor shqiptar të aplikuar në kuadër të këtij dokumenti dhe politikave të Bankës Botërore, në përputhje me ligjin nr. 10 428, datë 2.6.2011, "Për të Drejtën Ndërkombëtare Private" (neni 2)¹¹, marrëveshja ndërkombëtare mes tyre mbizotëron kuadrin ligjor; e njohur gjithashtu si epërsia e marrëveshjeve ndërkombëtare. Kredia aktuale midis Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Botërore për PZHIEU-në konsiderohet të jetë një traktat/marrëveshje ndërkombëtare dhe për këtë arsye nenet dhe specifikimet e saj mbizotërojnë ndaj ligjin përkatës të vendit.
- b. Ku pronari i tokës ka kontribuar me dëshirë ose vullnetarisht në tokë, por po kërkon kompensim, vlerësimi për kompensim do të trajtohet si në rastin e marrjes së tokës në mënyrë të pavullnetshme.
- c. Për tokën, pronari i së cilës ka kontribuar lirisht, por nuk kërkon kompensim, vlerësimi për kompensim do të përfshijë vetëm asetet mbi të dhe jo tokën.
- d. Kompensimi do të jetë i kufizuar për vlerësimet e bëra pas datës së vlerësimit social. Një studim census ose një mini-census do të ndërmerret për të vlerësuar gjendjen aktuale sociale sipas datës limit të vlerësimit, pasi kjo e fundit është përcaktuar nga projekti, duke qenë se një datë e tillë limit për vlerësimin social nuk është e parashikuar në ligjin shqiptar. Census-i do të ofrojë si produkt edhe një listë të aseteve të prekura nga aktivitetet e zbatimit të projektit.
- e. Të gjitha konfliktet e tokës do të zgjidhen në mënyrë transparente dhe në një mënyrë që nuk është detyruese. Përpjekjet duhet të bëhen për të zgjidhur konfliktet në çdo qytet. Kur kjo nuk është e mundur, gjykatat do të shërbejnë si ndërmjetës konsultues.

4.2 Kuadri Ligjor i Pronësisë dhe Kriteret e Vlerësimit të Pronësisë

Komuniteti dhe popullsia në zonat e projekteve do të ndikohet në pronësinë që zotërojnë gjatë zbatimit të PIUED sipas llojit të aktivitetit të projektit të zbatuar dhe ndikimeve sociale që lidhen me secilën kategori humbjesh. Më poshtë po paraqesim një tabelë me kategoritë kryesore të humbjes së pronës dhe llojet kryesore të ndikimeve, i shoqëruar nga tipi i pronarit.

¹¹Ligji nr.10 428, date 2.6.2011, "Për të drejtë ndërkombëtare private",
http://www.pp.gov.al/web/ligji_drejte_nderkombetare_private_1_571.pdf

Tabela 3. Kategoritë e Humbjes së Pronës

Aktivitet e Mundshme të Marra	Tipi i Ndikimit	Pronësia
Tokë	Preket më pak se 80% e tokës totale nga projekti. Pjesa tjetër e tokës mbetet ekonomikisht e shfrytëzueshme.	Pronari/Mbajtësi i Titullit të pronësisë
	Ndikohet më shumë se 80% e tokës. Pjesa tjetër e tokës mbetet ekonomikisht e pashfrytëzueshme.	Pronari/Mbajtësi i Titullit të pronësisë
Ndërtesa	Struktura të prekura plotësisht/pjesërisht	Pronari/Mbajtësi i Titullit të pronësisë
Të korra nga bujqësia	Kultura bujqësore të prekura nga përvetësimi i përhershëm i tokës ose përdorimi i përkohshëm	Pronari/Mbajtësi i Titullit të pronësisë
Pemë	Pemë të prera	Pronari/Mbajtësi i Titullit të pronësisë
Përvetësim i Përkohshëm	Përvetësim i përkohshëm	Pronari/Mbajtësi i Titullit të pronësisë
Humbje e Vendbanimit me Qira		Qiramarrës i Rezidencës ose Biznesit
Humbje e Biznesit		Pronar/Mbajtës i Biznesit
Biznes/Punësim	Humbje e përkohshme/momentale e biznesit apo punësimit	Pronari i Biznesit, Punonjësit
Zhvendosje/Zhvendosje	Shpenzimet e transportit dhe transitore të jetesës	Pronari/Mbajtësi i Titullit të pronësisë sipas zhvendosjes
PNP me jetesë vulnerabël		PNP nën linjën e varfërisë
Identiteti Socio-Ekonomik dhe Identiteti Kulturor		Komuniteti
Lehtësirat Publike		Komuniteti
Ndikime të Paparashikuara		

Në nenin 41/4 të Kushtetutës së Shqipërisë¹² është parashikuar: "Shpronësimet ose kufizimet e së drejtës së pronës që barazohen me shpronësim, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë."

Për më tepër, në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Neni 1 "E drejta e pronës", të Protokollit 1¹³, citohet: "Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk do të privohet nga prona e tij me përjashtim të interesit publik dhe në vartësi të kushteve të parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare".

¹² Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 41/4, http://www.pp.gov.al/web/kushtetuta_perditesuar_822.pdf

¹³ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Neni 1 "E drejta e Pronës", http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf

Në këtë frymë, është në fuqi ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen e përkohshme të pronës private për interes publik*¹⁴". Ligji i përmendur parashikon tërë procedurën se si fillon një procedurë shpronësimi, për cilën arsye, nga cili qëllim dhe sqaron të drejtën e pronarëve për të kundërshtuar vlerësimin e pronës së bërë në mënyrë të njëanshme nga institucionet shtetërore.

Gjithsesi, një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka përparësi në aplikim para një ligji të përbashkët. (Neni 116 i Kushtetutës së Shqipërisë¹⁵) Për më tepër, nëse një ligj krijon një konflikt me një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar me ligj, do të zbatohet marrëveshja ndërkombëtare. Ky parim është një garanci se marrëveshjet ndërkombëtare me Qeverinë Shqiptare dhe Bankën Botërore, për kredinë, do të zbatohet me prioritet duke prehaluar mbi legjislacionin në fuqi, sidomos me ligjin e përmendur "*Për Shpronësimet*".

Me poshte jepet një përmbledhje e shkurtër e parimeve të dhëna nga ligji "*Për shpronësimet*":

- Projekti ka për qëllim interesin publik (Neni 8 / ç i ligjit "*Për shpronësimet ...*")¹⁶;
- Subjekti përfitues në procesin e shpronësimit do të jetë ***Bashkia përkatëse në çdo qytet*** (Neni 9 i ligjit "*Për shpronësimet ...*")¹⁷;
- ***Bashkia*** duhet të paraqesë kërkesën se bashku me një listë të dokumenteve të nevojshme në Ministrinë e linjës, e cila është Ministria e Zhvillimit Urban dhe në Institutin e Monumenteve të Kulturës (me strukturën e qeverisë aktuale), (Neni 10 dhe 11 të Ligjit);
- Ministria e linjës duhet të ndjekë procedurën ligjore, për publikimin e kërkesës për shpronësim, për të mbledhur ankesat e pronarëve të ndikuar, si dhe përgatitjen e draftit të aktit nënligjor për Këshillin e Ministrave;
- Procedura do të konsiderohet e plotë, kur pronarët përmes një deklaratë të miratojnë transaksionin e pronës në favor të shtetit;
- Vendimi për shpronësimin (për pronarët që nuk pajtohen me shpronësimin) do të miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe do të hyjë në fuqi menjëherë, edhe ajo do të publikohet në Fletoren Zyrtare;
- Pronarët e prekur kanë të drejtën e ankimit për kompensim në Gjykatë dhe nëse ata nuk e ndjekin këtë procedurë, vendimi i Këshillit të Ministrave do të jetë një titull ekzekutiv.

Dy konsiderata të tjera ligjore duhet të merren në konsideratë:

– ***Zhvlerësimi i pasurisë***¹⁸

Gjatë ndërtimit për interes publik mund të ndodhë që disa prona nuk janë të nevojshme të merren plotësisht nga pronari, por në të njëjtën kohë pronari nuk do të jetë në gjendje

¹⁴Ligji nr. 8561, dated 22. 12. 1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen e përkohshme të pronës private për interes publik*", http://www.energija.gov.al/files/userfiles/Koncesione_2/2015/Ligji-8561.pdf

¹⁵Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 116, http://www.pp.gov.al/web/kushtetuta_perditesuar_822.pdf

¹⁶Ligji nr. 8561, dated 22. 12. 1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen e përkohshme të pronës private për interes publik*", Neni 8ç , http://www.energija.gov.al/files/userfiles/Koncesione_2/2015/Ligji-8561.pdf

¹⁷Ligji nr. 8561, dated 22. 12. 1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen e përkohshme të pronës private për interes publik*", Neni 9 , http://www.energija.gov.al/files/userfiles/Koncesione_2/2015/Ligji-8561.pdf

¹⁸Ligji nr. 8561, dated 22. 12. 1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen e përkohshme të pronës private për interes publik*", Neni 18 , http://www.energija.gov.al/files/userfiles/Koncesione_2/2015/Ligji-8561.pdf

të gëzojë pronën si më parë dhe kështu ai ka të drejtën të kompensohet për zhvlerësimin e pasurisë së tij. Situata përfshin zbatimin e disa kushteve të veçanta për përdorimin e pronës.

Situata është e dhënë me ligj si “Kompensim për Vlerën e Zhvlerësuar të Pronës” (neni 18), duke qenë se vlera i jepet pronarit për shpronësimin e pjesshëm. Kjo procedure nuk zbatohet aq shpesh në praktikë, por parashikohet në ligj dhe nëse pronarët janë të prekur në këtë mënyrë gjatë zbatimit të projektit, ata kanë te drejte te kërkojnë kompensim te plote te pronës se tyre.

– **Marrja e përkohshme në përdorim e pronës**¹⁹

Gjatë përvetësimit të tokës mund të ndodhë që prona të caktuara janë të nevojshme për tu marrë në zotërim për përdorim të përkohshëm, të tilla si rasti për zgjerimin e rrugës së fshatit që të kalojnë automjetet e mëdha gjatë punimeve për zbatimin e projektit. Në këto raste është marrë toka e dikujt përkohësisht duke ja rikthyer në gjendjen fillestare, por duke i paguar qera për kohën e përdorimit. Kërkesa për të marrë në përdorim të përkohshëm një pronë duhet të adresohet në Ministrinë e Zhvillimit Urban, e shoqëruar me përshkrimin e pronës, arsyen e marrje, kohën dhe vlerën e kompensimit për pronarin. Pronari ka të drejtë të ngrejë një ankesë në gjykatë kundër një vendimi të tillë.

4.3 Kriteret Ligjore për Vlerësimin dhe Kompensimin e Pronës²⁰

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 138 datë 23.3.2000²¹ parashikon kriteret ligjore për vlerësimin e pronave të prekura nga shpronësimi.

- **Toka:** Vlerësimi i tokës së shpronësuar do të përcaktohet për tokat urbane, tokat brenda vijës së verdhë të qytetit dhe pronat e njësisë administrative sipas çmimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave që derivojnë nga Ligji Nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave private”.²²
- **Pronat rezidenciale:** Vlera e kompensimit të shpronësimit për pronat rezidenciale (banesat) konsiderohet çmimi mesatar i shitjes, sipas të dhënave të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP).
- **Pronat industriale dhe bujqësore:** Vlera e kompensimit të shpronësimit për pronat industriale dhe bujqësore konsiderohet çmimi mesatar i shitjes, sipas të dhënave të Ministrisë së Zhvillimit Urban. Zhvlerësimi i pasurisë duhet të jetë vlerë e zbritur nga çmimi.
- **Toka bujqësore, zonat pyjore, etj:** Vlera e vlerësimit të tokave bujqësore, zonave pyjore, dhe kullotave është përcaktuar nga çmimet e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave private”. Në rastet ku nuk ka çmime të miratuara për rajone të caktuara, vlerësimi për tokat bujqësore, zonat pyjore, dhe kullota përcaktohet nga çmimi mesatar i shitjes i vënë në dispozicion nga ZRPP.

¹⁹Ligji nr. 8561, dated 22. 12. 1999 "Për shpronësimet dhe marrjen e përkohshme të pronës private për interes publik", Neni 27-37, http://www.energija.gov.al/files/userfiles/Koncesione_2/2015/Ligji-8561.pdf

²⁰Sipas ligjit shqiptar në fuqi.

²¹VKM Nr. 138 datë 23. 3. 2000,

http://www.transporti.gov.al/files/userfiles/Shpronësimet/VKM_138_date_23_03_2000.doc

²²Ligji Nr. 9235, dated 29. 7. 2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave private”, http://www.nchb.al/wp-content/uploads/2014/12/LIGJI_KTHIMIN_KOMPENSIMIN_E_PRONES.pdf

- **Pemët frutore:** Për pemët frutore vlera e parashikuar është llogaritur duke marrë parasysh kostot e investimeve dhe shpenzimet. Kjo vlerë është përlllogaritur për njësi (numri i pemëve frutore) ose njësi për sipërfaqen e tokës (m² i vreshtave etj.). Investimi i pranishëm në tokë, shpenzimet totale dhe faktorë të ndryshëm të amortizimit janë parashikuar nga direktiva/urdhëresa specifike të Ministrisë së Bujqësisë.²³
- **Të korrat:** Për të korrat, vlera është përlllogaritur në bazë të rendimentit që pritet dhe të njësisë së çmimit të tregut.²⁴
- **Ndërtimet e paligjshme:** Në raste e investimeve pronarët e pronave, të cilat nuk janë të regjistruara në ZRPP (pa tituj pronësie) shpronësohen. Subjekti, i cili inicion shpronësimin ka të drejtën të përfundojë procedurën e shpronësimit nëse: pronarët e pronës kanë filluar një proces administrativ në Agjencinë për Legalizimin dhe Integrimin e Pronave Informale (ALUIZNI) në bazë të Ligjit Nr. 9482, datë 3.4.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e pronave informale*"²⁵; në rast se ndërtimi i paligjshëm (ose punime shtesë në ndërtesën ekzistuese) ka qenë deklaruar më parë dhe është kualifikuar më vonë për lejen e legalizimit nga ALUIZNI, në bazë të kriterëve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 438, datë 28.6.2006 "*Për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin që përcakton legalizimin e pronave informale*"²⁶; në rastin kur pronarët e pronës janë në procesin e marrjes së një leje legalizimi, etj.

4.4 Kriteret e Bankës Botërore për Përcaktimin e së Drejtës për Kompensim

Sipas OP 4.12 të Bankës Botërore²⁷, kriteret për përcaktimin e së drejtës për kompensim, zhvendosje dhe masat e asistencës në rehabilitim për persona të zhvendosur, do të bazohet në:

- a. ata që kanë të drejta formale ligjore mbi tokën (përfshirë të drejtat zakonore dhe tradicionale të njohura sipas ligjeve të vendit);
- b. ata që nuk kanë të drejta formale ligjore mbi tokën në kohën që fillon studimi/vlerësimi/census-i, por kanë një kërkesë për të tilla toka ose pasuri - me kusht që këto kërkesat janë të njohura sipas ligjeve të vendit ose bëhen të njohura nëpërmjet një procesi të identifikuar gjatë planin të zhvendosjes;
- c. ata që nuk kanë të drejtë të njohur ligjore apo pretendim për tokën që ata janë të zënë.

Personat e prekur nga projekti të klasifikuar sipas paragrafit (a) dhe (b) duhet tu sigurohet kompensim, ndihmë për zhvendosje dhe rehabilitimin e tokës, ndërtesës ose aseteve fikse mbi tokën dhe ndërtesat e marra nga projekti. Kompensimi do të jetë në përputhje me

²³VKM NR. 138 datë 23. 3. 2000,

http://www.transporti.gov.al/files/userfiles/Shpronesimet/VKM_138_date_23_03_2000.doc

²⁴VKM NR. 138 datë 23. 3. 2000,,

http://www.transporti.gov.al/files/userfiles/Shpronesimet/VKM_138_date_23_03_2000.doc

²⁵ Për më tepër referojuni versionit të plotë të ligjit:

http://www.planifikimi.gov.al/sites/default/files/Ligji_nr.9482_per_legalizimin,_urbanizimin_dhe_integrimin_e_nderitimeve_pa_leje,%20i%20ndryshuar_1.pdf

²⁶Për më tepër referojuni: <http://www.aluizni.gov.al/vendim-nr-438-per-percaktimin-e-kriterëve-te-procedurave-dhe-dokumentacionit-te-zbatueshem-per-te-kualifikuar-objektet-ne-ndertim-qe-legalizohen-ose-jo/>

²⁷ OP 4.12 Banka Botërore,

<http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/PROJECTS/EXTPOLICIES/EXTOPMANUAL/0..contentM DK:20064610~menuPK:64701637~pagePK:64709096~piPK:64709108~theSitePK:502184,00.html>

dispozitat e këtij kuadri dhe nëse personat e prekur kanë “zaptuar” zonën e projektit përpara datës limit (data e fillimit të censusit). Personave të e mbuluar nga pika (c) më sipër duhet tu sigurohet ndihmë në zhvendosje në vend të kompensimit për tokën që ata kanë zënë. Përveç kësaj, ata duhet tu jepet ndihma e nevojshme për të përmbushur dispozitat e përcaktuara në këtë kuadër, nëse ata janë në zonën e projektit përpara përcaktimit të datës limit²⁸. Të gjithë personat e kategorizuara në tre nën-seksionet më sipër duhet tu sigurohet kompensim për humbjen e aktiveve të tjera përveç tokës. Si pasojë, kjo politikë advokon për një lloj ndihme për të gjithë personat e prekur, duke përfshirë banorë të paligjshëm ose persona të tjerë të cenuar në zonën e projektit, pavarësisht nëse ata kanë tituj formale/zyrtar të të drejtat ligjore apo jo. Megjithatë, të gjithë personat që vendosen në zonën e projektit pas datës limit nuk do të kenë të drejtë për kompensim ose ndonjë ndihmë tjetër. Komunitetet përfshirë në rrethe, qytete, lagje dhe fshatra të cilat humbasin në mënyrë të përhershme tokën, burimet dhe/ose asetet kanë të drejtë për kompensim. Madhësia e kompensimit duhet të sigurojë, që kushtet socio-ekonomike të komuniteteve përpara zhvendosjes të ruhen.

Politikat e Bankës Botërore kërkojnë zbatimin e legjislacionit vendas për vlerësimin dhe kompensimin e humbjeve për aq kohë sa përmes këtij zbatimi bëhet e mundur që të respektohen parimet e sanksionuara në dokumentet e saj zyrtare (Marrja e kostove të zëvendësimit për aktivet e humbura). Në çdo rast, siç edhe është përmendur më sipër, marrëveshja ndërkombëtare midis Qeverisë së Shqipërisë dhe Bankës Botërore mbizotëron kuadrin ligjor vendas). Kompensimi duhet të bëhet i plotë për aktivet të cilat preken në mënyrë të drejtpërdrejt nga projekti. Kështu, në dokumentin mbi Politikat Operacionale për Zhvendosjen e Pavullnetshme (OP 4.12) thuhet shprehimisht:

“Lidhur me tokën dhe strukturat, "kostoja e zëvendësimit" përkufizohet si vijon: Për tokën bujqësore, është vlera e tregut të tokës me kapacitet të njëjtë prodhimi ose përdorimi e vendosur në afërsi të tokës së prekur, përpara zbatimit të projektit ose përpara zhvendosjes (më e larta mes tyre), plus kostot e përgatitjes së tokës për ta sjellë në kushtet e tokës së prekur, plus kostot e çdo regjistrimi apo takse. Për shtëpitë dhe struktura të tjera, është vlera e tregut të materialeve që kërkohen për të ndërtuar strukturën e prekur ose për të rregulluar strukturat e prekura pjesërisht, plus kostot e transportit të materialeve në vendin e ndërtimit, plus kostot e punës dhe të çdo takse apo regjistrimi. Në përcaktimin e kostove të zëvendësimit, zhvlerësimi i aktiveve të materialeve nuk merret parasysh dhe as vlera e përfitimit nga projekti nuk i zbritet vlerës së aktivitetit.”

OP 4.12 gjithashtu është përcaktuar se nëse legjislacioni vendas nuk arrin standardin e kompensimit të përcaktuar nga Banka Botërore, domethënë në kosto të plota të zëvendësimit, kompensimi sipas legjislacionit vendas duhet të plotësohet me masa shtesë në mënyrë që të arrijë standardin e përcaktuar. Sidoqoftë sipas ligjit nr 10 428, datë 02.06.2011 “Për të

²⁸OP 4.12 Banka Botërore

Drejtën Privatë Ndërkombëtare²⁹ çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar nga ligji mbizotëron çdo dispozitë tjetër ligjore, kur këto dispozita nuk janë në një linjë me të.³⁰

4.5 Hapësirat midis Legjislacionit Shqiptar dhe Politikave të Bankës Botërore

Tabela 4. Tabela e Hapësirave midis Legjislacionit Shqiptar dhe Politikave të Bankës Botërore

Kategoria	Legjislacioni Shqiptar	Politika të Bankës Botërore	Sugjerime për Plotësimin e Hapësirës
<p>A. Humbja e tokës</p> <p>Familjet, njësitë ekonomike familjare</p>	<p>Kompensimi me çmimin e përcaktuar më parë për tokën urbane dhe bujqësore</p>	<p>Kompensimi me kosto të plotë zëvendësimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për tokë bujqësore të para-projektit ose para zhvendosjes, vlera e tregut e tokës me potencial produktiv të barabartë në zonat në afërsi, cilado vlerë është më e larta. - Për tokë urbane, vlera e tregut të tokës para zhvendosjes në madhësi dhe përdorim të barabartë, me objekte të ngjashme dhe burime në afërsi të njëjtë. - Zëvendësimi i tokës me potencial produktiv të ngjashëm. 	<ul style="list-style-type: none"> - Kompensim i plotë me çmimet e tregut; - Asnjë shpenzim për regjistrimin e tokës apo kosto administrative nuk do ti alokohet pronarëve.
<p>A. Humbja e tokës</p> <p>Personat pa titull pronësie</p>	<p>Nuk jepet kompensim</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ndihma për zhvendosje në vend të kompensimit për tokën e zaptuar (toka, para në dorë, dhe pasuri të tjera, punësimi) të paktën të rivendoset jetesa dhe standardet e jetesës se tyre në nivelet para-zhvendosjes. 	<ul style="list-style-type: none"> - Ndihmë për zhvendosje për personat vulnerabël për të rivendosur nivelin e jetesës para-zhvendosjes. Grupet vulnerabël përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: të varfër ose pa tokë, gratë kryefamiljare, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit. - Zaptuesit e tokës nuk kanë të drejtë për kompensim për shtrirjen e tyre të paautorizuar/paligjshme mbi tokën publike. - Zaptuesit me humbje ekonomike kanë të drejtë për ndihmë në restaurimin e jetesës.
<p>B. Humbja e banesave, strukturave</p> <p>Familjet, njësitë ekonomike familjare, Pronarët e Strukturave</p>	<p>Kompensime çmime të referuara nga Zyra Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme; Kompensimi për strukturën e pa titullin me kusht që kanë aplikuar më parë për legalizim në</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kompensimi me kosto të plotë zëvendësimi. - Për shtëpi dhe struktura, kosto e materialeve dhe punës për të ndërtuar një strukturë zëvendësimi me një cilësi të ngjashme ose më të mirë se struktura e ndikuar. 	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji parashikon të njëjtin standard me Bankën Botërore, që do të thotë se askujt nuk do ti mohohet asnjë mundësi e mëtejshme për kompensim.

²⁹Ligji nr.10 428, date 2.6.2011, “Për të drejtë ndërkombëtare private”, (neni 2), http://www.pp.gov.al/web/ligji_drejtën_nderkombetare_private_1_571.pdf

³⁰Siç është shpjeguar më parë në tekstin, kjo do të thotë se në rast të ndonjë hapësire ose mospërputhjeje të ligjit shqiptar me politikat e Bankës Botërore, marrëveshja ndërkombëtare mes tyre mbizotëron kuadrin legjislativ; kjo njihet njohur gjithashtu si epërsi e marrëveshjeve ndërkombëtare.

	Agjencinë e Legalizimit;		
C. Humbja e aseteve ekonomike <i>Familjet,</i> Njësitë ekonomike familjare	Kompensimi me metodën e kostos së vlerësimit të objektit.	– Kompensimi me kosto të plotë zëvendësimi	– Ligji parashikon të njëjtin standard me Bankën Botërore, që do të thotë se askujt nuk do ti mohohet asnjë mundësi e mëtejshme për kompensim.
D. Humbja e të ardhurave	Nuk parashikohet	– Masa për të ndihmuar personat e ndikuar në përmirësimin e standardeve të jetesës së tyre të mëparshme, kapacitetin e fitimit të të ardhurave, nivelet e prodhimit, ose të paktën zhvendosjen e tyre.	– Ndihma për rehabilitimin e mjeteve të jetesës së humbur ose zvogëluar. – Në rastin e familjeve pa tokë të cilat vuajnë humbjen e pjeseshme ose totale të mjeteve të jetesës, sigurimi i mundësive për gjenerim të ardhurash dhe mekanizma mbështetëse.
E. Humbja e burimeve të komunitetit	Kompensimi nga ana e Qeverisë me vlerën e tregut.	– Masat për të ndihmuar komunitetet e ndikuara për të rikrijuar ose ri-zhvilluar burimet e humbura të komunitetit.	– Kompensimi për ri-vendosjen ose rindërtimin e burimeve të humbura të komunitetit të tilla si strukturat fetare dhe kulturore, strukturat e ujitjes. – Rikthim i strukturave të ndikuara pjesërisht.

5. Aspektet e Përgjithshme Mjedisore në Jugun e Shqipërisë

5.1 Përmbajtja

Projekti i propozuar pritet të përqendrohet në jug të Shqipërisë duke përfshirë zonën ndërmjet Vlorës dhe Sarandës duke mbuluar bregdetin dhe pjesën në brendësi (përfshirë Beratin, Përmetin dhe Gjirokastrën).

Bregdeti Jonian i Shqipërisë konsiderohet si burimi më i rëndësishëm nga varet zhvillimi i ardhëshëm i vendit. Aktivitetet e projektit synojnë ruajtjen e vlerave natyrore e kulturore dhe krijimin e kushteve për zhvillim ekonomik dhe turizmit në veçanti.

Peizazhi i rajonit bregdetar jugor është i karakterizuar nga një topografi e thyer e cila përcakton kuadrin për zhvillimin natyror të habitateve dhe ndikimin e njeriut në këto habitate gjatë kohës. Rezultati është një rajon i ndikuar nga dy forma të peizazhit, konkretisht peizazhet natyrore (zonat natyrore dhe habitate të zhvilluara natyrshëm); dhe peizazhet kulturore (ndërtesat tradicionale me veçoritë e tyre, asete të tjera të trashëgimisë së bashku me bujqësinë, pemëtarinë dhe forma të tjera të përdorimit të tokës).

Vlerësimin i pranisë dhe rëndësinë së peisazheve kulturore është çelësi për të kuptuar konceptin e mbrojtjes së natyrës në rajonin Bregdetar Jugor.

Në vijim janë identifikuar si pika të mundshme me interes turistik në pjesën jugore të Shqipërisë: Zvërnec, Qyteti i Vjetër i Orikutit, Porto Palermo, Borsh-Zagori, Kisha e Labovës, Kështjella e Libohovës dhe Kazemat e Vjetëra të Ushtrisë në Këlcyrë etj.

Në aneksin nr. 3 jepet përshkrimi i këtyre vendeve të identifikuara si potenciale turistike. Vende të tjera mund të identifikohen dhe propozohen nga komunat përfituese në listën përfundimtare por ndikimet e projektit do të jenë të ngjashme me ato të tipit B. Nuk parashikohet të ketë ndikime të tipit A për gjithë aktivitetet e projektit.



Figura 1. Harta e Shqipërisë sipas Sesionit Hartografik të OKB

Burimi: Harta e Shqipërisë bazuar në Seksionin Hartografik KB-së

(Zona bregdetare jugore e kufizuar nga vija e ndërprerë blu; zona e brendshme Berat-Përmet-Gjirokastër e kufizuar me vijë të ndërprerë ngjyrë kafe)

5.2 Biodiversiteti i Zonës

Rajoni Bregdetar Jugor i Shqipërisë karakterizohet nga një diversitet i konsiderueshëm i florës, habitateve dhe shoqërimeve bimore me një rëndësi të veçantë kombëtare. Një numër i llojeve bimore të zonës shfaqet në listën kombëtare të llojeve të rralla, një numër i konsiderueshëm i bimëve dallohen për interesin e tyre të veçantë shkencor, ndërkohë që shumë prej tyre janë me vlera të veçanta ekonomike si bimë medicinale, vajore, industriale ose bimë dekorative etj.

Bregdeti Jugor i Shqipërisë paraqet një udhëkryq të rëndësishëm të rrugëve migratore të faunës në rajonin e Ballkanit. Zona është shumë e pasur me pothuajse 1,400 specie bimore (që përfaqësojnë më shumë se 40% të totalit të florës të Shqipërisë). Një numër i madh i llojeve të rralla dhe të rrezikuara të Shqipërisë gjenden në këtë zonë. Shumë lloje bimore endemike dhe relikte gjenden brenda zonës së studimit. Llojet kryesore të habitateve me bimësi natyrore që gjenden në zonat Bregdetare Jugore janë³¹:

- Vegjetacioni i zonës së ulët ose pyje me gjelbërim të përhershëm dhe shkurre,
- Pyjet mesdhetare me pisha (Assoc. *Pistacio- Pinetum halepensis*) që nuk janë indigjene për zonën,
- Bashkësitë bimore të dominuara nga *Euphorbia dendroides*, *Pistacia lentiscus* – *Allianca Oleo* – *Ceratonion* (Assoc. *Pistacchio* – *Euphorbietum dendroides*),
- Bimësia frigana (Assoc. *Chrysopogono* – *Phlometum fruticosae*, Assoc. *Ericetum manipuliflorae*),
- Bimësia pseudo-stepë e dominuar nga *Brachypodium ramosum* (Assoc. *Brachypodium ramosi*),
- Oak pyje gjetherënës (Assoc. *Quercetum frainetto*),
- *Quercus ithaburensis subsp. macrolepis*,
- Pyjet halore (Assoc. *Pineto* – *Abietetum borissi-regis*), dhe
- Pyje që dominohen nga *Pinus leucodermis* (Assoc. *Pinetum leucodermis typicum*).

Bregu i Jugut të Shqipërisë ka një diversitet të pasur të faunës. Në veçanti, zona ka një faunë shumë të pasur me insekte (jo vertebrore). Për më tepër, 11 lloje amfibësh (nga 15 specie të njohura në vend), 30 specie zvarranikësh (nga 37 specie të njohura në vend) mund të gjenden në këtë zonë. Rreth 250 specie zogjsh janë raportuar nga zona, nga 330 lloje të njohura në vend duke e bërë rajonin e Bregdetit të Jugut një zonë shumë të rëndësishëm për zogjtë.

Zona është një vend i rëndësishëm për shpendët grabitqarë me skifterin kthetrazi dhe hutën egjiptiane. Zogjtë ujorë janë të rëndësishëm në pjesën jugore të zonës, Liqeni i Butrintit ka qenë kohët e fundit përcaktuar si një zonë Ramsar.

³¹from: MedWedCoast 2005: Management Plan. Complex: Llogara - Rrëza e Kanalit - Dukat - Orikum - Tragjas - Radhimë - Karaburun. Final Draft. GEF/UNDP-MoE Conservation of Wetland and Coastal Ecosystem in the Mediterranean Region.

Zona e studimit është shumë e pasur me gjitarë. Rreth 55 specie nga 71 specie të njohura në Shqipëri mund të hasen përgjatë Bregdetit Jugor të Shqipërisë. 17 lloje gjitarësh listohen në Listën e Kuqe.

5.3 Zonat e Mbrojtura

Një gamë e gjerë e habitateve janë gjetur në zonën e studimit të tilla si: ekosistemet e maleve të larta (deri në 2,000 m); kullota alpine dhe sub-alpine; lloje të ndryshme të pyjeve (conifer të përziera dhe gjethegjërë, gjethegjërë të përzierë të dominuar nga pemë me gjelbërim të përhershëm, shkurre dhe makiet, pyjet aluviale); kullota fushore; rërë dhe shkëmbinj bregdetare; ligatinat bregdetare si ajo e liqenit të Butrintit, Liqeni i Bufit dhe Laguna e Orikumit; përrënjtë dhe burimet karstike; shpella, etj

Në Aneksin nr. 3 në mënyrë të përmbledhur janë treguar të dhëna gjeografike të zonave të mbrojtura natyrore të cilat janë në zonën influencës së projektit. Një tabelë e zonave të mbrojtura në zonën e projektit është paraqitur më poshtë.

Tabela 5. Zonat e Mbrojtura në Rajon

Nr	Emri i Zonave të Mbrojtura	Vendodhja	Shënime
1	Vjosë-Nartë	Vlora	Peizazh i mbrojtur
2	Karaburun	Vlora	Rezervë natyrore e mbrojtur dhe Park Natyror
3	Karaburun-Sazan	Vlora	Park Kombëtar
4	Llogara	Vlora	Park Kombëtar
5	Porto Palermo	Vlora	Peizazh i mbrojtur
6	Butrinti	Saranda	Park Kombëtar, Zonë e trashëgimisë Kulturore UNESCO, dhe zonë Ramsar

6. Procedura dhe udhëzime për të adresuar çështjet mjedisore dhe sociale të projektit

6.1 Parime orientuese dhe përqasja kryesore

Në përgjithësi, parimet udhëzuese për zhvillimin e instrumenteve të vlerësimit mjedisor të projektit do të përfshijë konceptet e mëposhtme:

1. *Integrimi i objektivave mjedisore dhe sociale në procesin e studimit të fizibilitetit.* Këto studime mund të ofrojnë mundësi të mira për integrimin e objektivave mjedisore dhe sociale si pjesë e procesit të planifikimit. Në këtë rast në ToR duhet të përfshihen objektivat mjedisore dhe sociale si pjesë e studimit.
2. Promovimi i transparencës përmes pjesëmarrjes së aktorëve dhe përfshirjes së publikut. Studimet tregojnë se angazhimi dhe pjesëmarrja e gjerë e palëve të interesuara është një mundësi e shkëlqyer për të promovuar një planifikim të përmirësuar.
3. Promovimi i analizës së alternativave
4. Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale.

Projekti do të ofrojë një mundësi për të ndërtuar kapacitete homologe dhe përfshirjen e çështjeve mjedisore dhe sociale në punën e tyre. Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve do të vijë në formën e trajnimit, monitorimit dhe raportimit.

6.2 Procesi i Shqyrtimit dhe Ndikimet Mjedisore

Aktivitetet e projektit do të kenë ndikime të ngjashme dhe masat zbutëse e monitoruese përkatëse. Nuk janë parashikuar ndikime mjedisore të rëndësishme ose në shkallë të gjërë. Ndikimet do të jenë të lidhura me emetimet e pluhurit, zhurmat, mbetjet e ngurta, ujërat e ndotura të krijuara para dhe pas aktiviteteve të ndërtimit etj.

6.2.1. Shqyrtimi dhe Studimi

Të gjitha aktivitetet e projektit do të jetë subjekt i një shqyrtimi mjedisor për të parandaluar ekzekutimin e projekteve me ndikime të rëndësishme negative mjedisore. Efektet mjedisore vlerësohen dhe gjykojnë nga vlera e ndryshimit të shkaktuar mbi mjedisin fizik, biologjik, ekonomik ose social. Niveli i ndikimit varet nga kohëzgjatja, kthyeshmëria, madhësia, përfitimi, rëndësia etj.

Projekti do të ketë përqasje të propozuar në vijim për adresimin e çështjeve mjedisore dhe sociale duke përfshirë instrumentet e mëposhtme mbrojtëse:

- Kuadri i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS) përgatitur para vlerësimit dhe miratimit të PZHIEU-së për të informuar lidhur me performancën e përgjithshme mjedisore dhe sociale të projektit;
- Dy PMMS për aktivitetet që do të fillojnë vitin e parë të cilat janë identifikuar në kohën e vlerësimit: (i) rehabilitimi i kalldrëmit të rrugëve që çojnë në Kalanë e Beratit dhe (ii) rehabilitimi i shkallëve në qytetin e Sarandës;
- Një shqyrtim paraprak për nën-projektet e identifikuar (për vitin e parë dhe vitet e mëvonshme të zbatimit të projektit) të zgjedhur në përputhje me specifikat dhe kriteret, do të identifikohen çështjet që do të përfshihen në Termat e Referencës për Studimet e Fizibilitetit. ToR-et për Studimet e Fizibilitetit do të përfshijnë dispozita për masat mbrojtëse mjedisore dhe sociale, duke përfshirë ndikimet afatgjata, në mënyrë që produkti të përgatitet duke marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në mjedis;
- Gjatë ose pas studimit të fizibilitetit, shqyrtime shtesë për nën-projektet do të kryhen nga FSHZH (PMU), për të përcaktuar nëse një plan i posaçëm për Menaxhimin Mjedisor dhe Social është ose jo i nevojshëm.
- Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) dhe/ose Planet e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS), dhe instrumente të tjera mbrojtëse janë të nevojshme (p.sh. listat e kontrollit, Planet e Veprimit për Zhvendosje (PZHV-të), etj) do të përgatitet nga konsulentë të përzgjedhur nga FSHZH-ja për të gjitha investimet me Studime të Fizibilitetit të përfunduara dhe detajet teknike do të jenë në dispozicion gjatë zbatimit të projektit në vijim të udhëzimit të përcaktuar në këtë dokument;
- Instrumenti kryesor do të jetë PMMS-ja për të monitoruar të gjitha ndikimet që lidhen me ndërtimin. Shqyrtimi shtesë i projektit do të përcaktojë nëse janë apo nuk janë të nevojshme instrumente të tjerë.

6.2.2 Ndjeshmëria e mjedisit

Masat mbrojtëse do të jetë në përputhje me ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale. Procesi i shqyrtimit të projektit do të përcaktojë ndjeshmërinë e mjedisit.

Projekti i PZHIEU-së do të zhvillohet në zonat me nivele të ndryshme ndjeshmërie. Në figurën më poshtë zonat me kritere kulturore dhe të trashëgimisë si Berati, Gjirokastra mund të vlerësohen si me ndjeshmëri të lartë. Në vende të tjera ndjeshmëria mjedisore ndryshon sipas çdo rasti. Zonat me status të zakonshëm mund të vlerësohen me ndjeshmëri të mesme

Edhe pse, mjedisi është i ndjeshëm në disa raste, projekti nuk pritet të ketë ndikime mjedisore ose sociale të rëndësishme ose të pakthyeshme me natyrën rehabilituese të punëve që do të financohen. Problemet me tokën parashikohen të vogla dhe periferike meqenëse puna do të zhvillohet në infrastrukturën ekzistuese në pronë publike.

6.2.3 Përcaktimi i kategorisë së aktiviteteve të projektit

Aktivitetet e projektit pritet të jenë në nivelin e kategorisë B, në bazë të kritereve të BB dhe të VNM-së të Shqipërisë. Aktivitetet e projektit mund të vlerësohen në bazë të magnitudës së ndikimit, ndjeshmërinë së mjedisit dhe nivelit të rëndësisë së efektit (figura 2). Ndikimet e mundshme negative në mjedis mund të përfshijnë: (i) ndërtime të përkohshme që shkaktojnë zhurmë, pluhur, ndotje të ajrit; (ii) ndikimet e përkohshme të lokalizuara në cilësinë e ujit nga rrjedhjet dhe kanalet e ujërave të ndotura; dhe (iii) ndryshime të përkohshme në aksesin ndaj hapësirave publike gjatë ndërtimit.

Punimet rehabilituese në shkallë të vogël janë parashikuar në Ishullin e Zvërnecit dhe Lagunën e Nartës, tek Syri i Kaltër të cilat janë zona të mbrojtura në përputhje me legjislacionin kombëtar. Megjithatë, këto ndërhyrje rehabilituese fizike nuk do të çojë në konvertimin ose degradimin e habitateve natyrore.

Tabela 6. Komponentët e projektit, aktivitetet e mundshme dhe ndikimi i tyre

(M=mesatar; U= i ulët; NZ=nuk zbatohet)

Komponenti 1. Përmirësimi i urbanistikës dhe infrastrukturës				
Nën komponenti 1A: Përmirësim i integruar i urbanistikës	Zona e aktivitetit	Aktivitetet e projektit që do të zbatohen	Ndjeshmëria mjedisore e zonës	Madhësia dhe rëndësia e efektit
	Gjirokastra, Berat Përmet Saranda.	Përmirësimi i parqeve, sheshit të qytetit, rrjetet e rrugëve dhe infrastrukturës shoqëruese	M, U	M, U
		Rehabilitimi i trotuareve, ndriçimi i rrugëve, vende turistike, qendrës, vendparkimeve, sinjalistikës etj.	M, U	M, U
		Restaurimi i fasadave dhe çatave të ndërtesave të trashëgimisë dhe përmirësimi i fasadave të shtëpive të banimit.	M, U	M, U

		Furnizim me ujë rehabilitimi i rrjetit të kanalizimeve dhe grumbullimi i mbeturinave të ngurta.	M, U	M, U
Nën komponenti 1B: Përmirësimi i qyteteve dhe integrimi i zonave satelit (rreth tyre)	Zvërnec-Narta P-Palermo Orikum Butrinti Syri i Kaltër	Restaurimi i objekteve të përzgjedhura të trashëgimisë dhe aseteve kulturore. Përmirësimi i infrastrukturës si p.sh aksesi në km e fundit, rrugët e këmbësorëve, qendrat e vizitorëve dhe sinjalistika. Krijimi i vendeve për të ndaluar dhe çlodhur dhe pikave të vrojtimit ose panoramike përgjatë korridorit turistik.	M, U	M, U
Komponenti 2. Zhvillimi i kapaciteteve institucionale			NZ	NZ
Komponenti 3: Mbështetje në zbatim			NZ	NZ

Komponenti 2 ka për qëllim të financojë punimet fizike të lidhura me revitalizimin e zonave urbane përgjatë bregdetit jugor, duke përfshirë rehabilitimin dhe përmirësimin e infrastrukturës bashkiake (rrugët dhe vendet publike të furnizimit me ujë dhe të rrjeteve sanitare, etj), si dhe restaurimin e ndërtesave të njohura historike. Aktivitetet e parashikuara nuk pritet të ketë ndikime negative mjedisore ose sociale të pakthyeshme. Në fakt ndikimet e pritshme janë kalimtare, periferike dhe jo të rëndësishme.

Komponenti 2 mbështet një lloj tjetër aktivitetesh që lidhen me ndërtimin e kapaciteteve që kanë të bëjnë me zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në zonat ku fokusohet projekti duke përfshirë mbështetjen e pushtetit lokal për menaxhimin e procesit.

Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve, si dhe studimet teknike, përfshirë edhe studimet e kryerjes dhe planifikimi i detajuar të investimeve, do të përfshijnë shqyrtimin e riskut mjedisor dhe social, vlerësimin e ndikimeve në përputhje me politikat operationale përkatëse të Grupit të Bankës Botërore.

6.2.4 Menaxhimi i Efekteve Mjedisore, procedura dhe udhëzime

Janë identifikuar tre aktivitete për tu zbatuar në vitin e parë. E para është Kalaja historike e Beratit në të cilëndo të rinovohet një rrugë me kalldrëm si akses për këmbësorët, zona ekzistuese e parkimit do të zgjerohet, një rrugë ekzistuese me kalldrëm do të zgjerohet e do të përmirësohet për akses automjetesh dhe do të bëhen ndërhyrje të vogla në bazë kështjellës. PMMS-ja për rinovimin e rrugës me kalldrëm është përgatitur në përputhje me KMMS-në e PZHIEU-së. Rehabilitimi i rrugës këmbësore me kalldrëm në Kalanë e Beratit nuk pritet të shkaktojë ndikime të rëndësishme mjedisore dhe ato që mund të ndodhin mund të zbuten lehtësisht nëpërmjet praktikave më të mira të ndërtimit dhe masave adekuate zbutëse të përshkruara në Planin e Menaxhimit Mjedisor Social.

Aktiviteti i dytë i identifikuar është rehabilitimi i shkallëve dhe/ose zgjerimi i shëtitorës buzë detit në qytetin e Sarandës. Gjithashtu, një PMMS është përgatitur në përputhje me KMMSnë për këtë aktivitet.

Rehabilitimi i shkallëve dhe shëtitorës në Sarandë nuk pritet të shkaktojë ndikime të rëndësishme mjedisore dhe ato që mund të ndodhin mund të zbuten lehtësisht nëpërmjet

praktikave më të mira të ndërtimit dhe masave adekuate zbutëse të përshkruara në detaje në Planin e Menaxhimit Mjedisor Social.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet menaxhimit të mbeturinave dhe rrjedhjeve pasi projekti është i vendosur pranë bregut. Ruajtja e mbetjeve mund të bëhet përkohësisht në një vënd të papërshkueshëm dhe larg sistemit të drenazhimit.

Ndikimet sociale që lidhen me shkallët janë të vogla dhe kryesisht kanë të bëjnë me çështjet e aksesit dhe vazhdimësisë së biznesit. Zgjerimi i shëtitores mund të ndikojnë në përdorimin e tokës dhe aktiviteteve ekonomike në këtë vend bregdetar. Shmangia e ndikimeve mjedisore dhe sociale, reduktimi dhe zbutja e tyre do të merren plotësisht në konsideratë gjatë përgatitjes së planeve të ndërtimit.

PMMS-të për këto dy aktivitete konfirmojnë se nuk do të ketë nevojë për blerje të tokës ndaj dhe parashikimi i procedurave nuk është i nevojshëm. PMMS-të kanë përcaktuar masa të veçanta për të zbutur ndikimet sociale të tilla si: këshillime, kryerja e punimeve jashtë sezonit turistik etj.

Në aneksin 4 Plani i Lehtësimit dhe aneksin 5 Plani i Menaxhimit janë paraqitur ndikimet e mundshme, masat zbutëse, kërkesat dhe udhëzimet për monitorimin e tyre.

Tabelat do të përdoret si një udhëzues dhe do të rishikohet në vazhdimësi pasi aktivitetet e projektit do të bëhen të njohura, në mënyrë të veçantë detajet teknike.

Monitorimi i parametrave kryesorë do të sigurojë identifikimin çështje kryesore ku do të fokusohen institucionet përkatëse. Do të parashikohen masa specifike për aktivitete të veçanta mbas kryerjes së studimit të kryerjes për investimet në infrastrukturë gjatë zbatimit të projektit.

6.3 Procesi i Shqyrtimit Social dhe Procedurat dhe Udhëzimet për Menaxhimin e Ndikimeve

6.3.1 Parimet e Menaxhimit Social të Projektit

PZHIEU-ja do të përfshijë parimet kryesore, në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare për zhvendosjen dhe Politikën për Zhvendosje të Bankës Botërore

- i. **Konsultimi dhe pjesëmarrja e komuniteteve të ndikuara:** Përgjatë procesit të zhvillimit dhe zbatimit të projektit dhe aktiviteteve të tij specifike, konsultimet me komunitetet e prekura dhe aktorët relevantë është një element thelbësor në angazhimin e qytetarëve, çka është baza për mbështetjen publike, përfshirjen e palëve të interesuara, dhe për një rezultat pozitiv të një aktiviteti të caktuar. Aty ku ndikimet e marrjes së tokës janë një faktor në një aktivitet të caktuar, duhet të ndërmerren konsultime mbi procedurat e kompensimit për marrjen e tokës, dhe ndikimet e lidhura dhe të dokumentohen në instrumentet e risistemimit për secilin aktivitet të veçantë; (Plani i Veprimit për Zhvendosje (PVZH) ose PVZH i shkurtuar për ndikimet në më pak se 200 njerëz (PVZSH)). Pjesëmarrja e PNP në përgatitjen dhe zbatimin e PVZH është thelbësore për një zhvendosje transparente dhe efektive.
- ii. **Minimizimi i zhvendosjes:** Është thelbësore për të treguar që hartimet dhe konfigurimet e aktiviteteve specifike të projektit të mbështetur nga projekti do të minimizojnë çdo ndikim fizik dhe ekonomik te familjet dhe komunitetet.
- iii. **Sigurimi dhe garantimin i kompensimit të nevojshëm apo të drejtave të përpara marrjes së tokës apo kufizimit për qasjen në tokë.**
- iv. **Transparenca e faktorëve që përcaktojnë kompensimin:** Duhet të arrihet një konsensus me ata që do të preken në mënyrë që të ketë një kompensim të drejtë dhe të barabartë për tokën, strukturat, pemët, dhe pasuritë e tjera të prekura. Kompensimi do të përcaktohet në bazë të vlerës së zëvendësimit, duke përfshirë materialet, punën, dhe transportin për strukturat dhe asetet fikse. Toka do të kompensohet me çmimet mbizotëruese të tregjeve në zonë. Aty ku toka është një burim i rëndësishëm ekonomik, sigurimi i tokës zëvendësuese (tokë për-tokë) është opsioni i parë.
- v. **Zhvendosja duhet të bëhet për të siguruar përfitim të PNP:** ata të cilët janë të ndikuar duhet tu jepet prioritet në mundësitë e punësimit që dalin nga projekti.
- vi. Në rast se ndodh diçka përgjatë zbatimit, çdo ndikim i mundshëm do të trajtohet duke përdorur të njëjtat masa si për menaxhimin e ndikimeve të mëpërparshme. Nëse opsioni i zgjedhur është përdorimi i një OJQ për të monitoruar dhe mbikëqyrur, atëherë detyrat e veçanta të OJQ-së janë një element shtesë i dobishme. PVZH-ja do të dokumentojë alternativat e konsideruara dhe të zgjedhura në këtë drejtim. I njëjti kuadër politike zhvendosjeje do të zbatohet më vonë gjatë zbatimit të projektit nëse ka ndikime të paparashikuara mbi njerëzit.
- vii. **Vendosja e të dhënave bazë të zhvendosjes:** Aktivitetet e mëposhtme do të përfundojnë në mënyrë të suksesshme për të pasur një inventar të pronave të prekura. Aktivitetet që do të ndërmerren:
 - **Një Inventari i aktiveve dhe tokës së ndikuar,** përdorimi dhe madhësinë e saj, të nevojshme për të ndihmuar të përcaktuar nivele të drejta dhe të arsyeshme për kompensim ose masa të tjera lehtësuese të rena dakord me personin e ndikuar.
 - **Një census-vëzhgim me bazë socio-ekonomike, i cili jep detaje demografike të familjeve, gjendjen shëndetësore,** nivelet e të ardhurave dhe punësimit. Regjistrimi bazë i të dhënave do të përdoret në kombinim me vëzhgimet mbi tokën dhe asetet për

- të lehtësuar identifikimin e zbutjes së rënë dakord dhe të përshtatshme dhe për të drejtat e personave apo palëve të ndikuara.
- viii.** Vendosija e **bazës së të dhënave të kompjuterizuara të cilat:** lehtësojnë zbatimin, mundësojnë monitorimin dhe përshtatin menaxhimin, dhe sigurojnë të dhëna të mjaftueshme për të kryer një vlerësim përfundimtar me qëllim mbylljen e ndonjë çështjeje të pazgjidhur.
- ix.** **Konsideratat për grupet sociale vulnerabël:** Këto janë grupe që përfshijnë popullsinë me asete minimale, analfabetë dhe/ose të moshuar (ato PNP mbi 65 vjeç). Këta individë janë shpesh të dobët fizikisht, dhe zakonisht kanë nevojë për ndihmë të veçantë në fazën e zhvendosjes. Dallimet gjinore do të monitorohen pasi familjet me kryefamiljare femra mund të humbasin ndaj familjeve më të fuqishme.
- x.** **Kostoja paraprake e Projektit të Zhvendosjes:** Kostot lehtësuese të vlerësuara në PVZH do të konsiderohen në buxhetin e përgjithshëm të projektit, si kosto paraprake. Këto kosto duhet të disbursohen, ose të përfituesit si e drejtë ose në formën e një mase tjetër zbutëse e përshtatshme e rënë dakord me personin ose palën e ndikuar.
- xi.** **Një procedurë e pavarur monitorimi dhe ankimi:** Përveç ngritjes së mekanizmit monitorues, një ekip i pavarur i përbërë nga zyrtarë të administratës lokale, Njësisë Koordinuese të Projektit, zyrtarët miqësorë të OJQ-ve dhe vendasit do të luajë një rol kyç në monitorimin dhe zbatimin e PVZH. Një mekanizëm i ankesave i nevojshëm për të zgjidhur problemet dhe për të menaxhuar çështjet e paparashikuara që mund të lindin gjatë zbatimit do të organizohet në mënyrë të tillë që ato të jenë të arritshme për të gjithë, me shqetësim të veçantë për situatën e grupeve vulnerabël. Monitorimi do të jetë një ndërmarrje e përbashkët nën drejtimin e OJQ-ve për të matur dhe vlerësuar ndryshimin në statusin e familjeve të ndikuara nga projekti.
- xii.** **Rreziqet potenciale të mbrojtjes sociale dhe masat zbutëse:**
- MZHU-ja verifikon në kohën e zbatimit të projektit, në qoftë se ndonjë nga banorët ka pretendime pronësie mbi pronën në rastin kur kjo është një tokë publike. Nëse dikush ka pretendime të tilla pronësie, Ministria duhet të ndihmojë ata për të marrë titujt e pronësisë dhe ti kompensojë për pronën e shpronësuar.
 - Përfshirja e një fondi rezervë shpronësimi prej 10% të shumës totale të kompensimit, për çdo kërkesë të papritur për kompensimin e tokës nga PNP, të cilët mund të kërkojnë kompensim shtesë dhe të fitojnë rastin në gjykatë.
 - Një fazë para-botimi rekomandohet në rastin kur PNP-të nuk janë identifikuar si psh. personat që nuk banojnë në zonat e shpronësuara (kanë emigruar në një rajon tjetër të vendit apo kanë emigruar jashtë vendit). Njoftimi duhet të bëhet nga MZHU-ja nëpërmjet publikimit të emrit në gazetën e fshatit, dhe në të paktën në dy gazeta me shpërndarje kombëtare dhe lokale për një periudhë prej një muaji (çdo të diel).
 - Një dispozitë e veçantë duhet të merret para fazës së dhënies së informacioneve shpjeguese për publikimin e emrave dhe kontakteve të pronarëve që do të shpronësohen. Bazuar në legjislacionin shqiptar "Mbi të dhënat personale" fshehtësia duhet të mbahet për emrat dhe kontaktet gjatë botimit të PVZH. Në këtë drejtim, MZHU-ja duhet të mbajnë kontakte me PNP-të dhe t'i pyesin ata paraprakisht nëse ata pranojnë të kenë emrin e tyre të plotë të botuar në gazetë.
- xiii.** **Procedura Operacionale e Bankës Botërore për Zhvendosjen e Pavullnetshme:** Politika operacionale e Bankës Botërore 4.12 për zhvendosjen e pavullnetshme kërkon që Zhvendosja e pavullnetshme të shmanget kur është e mundur, ose të minimizohet, duke eksploruar të gjitha planet alternative të projektit në praktike. Aty ku nuk është e mundur të shmanget Zhvendosja, veprimtaritë e zhvendosjes duhet të konceptohen dhe zbatohen si *programe të zhvillimit të qëndrueshëm*, duke siguruar burime të mjaftueshme investime për të mundësuar personat e rivendosur (nëse ka) të

përfitojnë nga projekti. Personat e rivendosur duhet të konsultohen plotësisht dhe duhet të kenë mundësi të marrin pjesë në planifikimin dhe zbatimin e programeve të strehimit. Ata gjithashtu duhet të ndihmohen në përpjekjet e tyre për të përmirësuar jetesën e tyre dhe standardet e jetesës ose të paktën tu rikthehen, në terma realë, nivelet mbizotëruese para-zhvendosjes ose para fillimit të zbatimit të projektit, cilado është më e lartë.

- xiv. **Kur ndodh Zhvendosja apo humbja e strehimit**, politikat kërkojnë që masat për të ndihmuar personat e rivendosur të zbatohen në përputhje me planin e zhvendosjes dhe kompensimit të veprimit (matrica e të drejtave).

6.3.2 Procesi i Shqyrtimit në Përvetësimin e Tokës dhe Zhvendosjen

Një ndikim social është një vlerësim i vlerës dhe rëndësisë së humbjeve të mundshme që komuniteti ka në kuadër të zbatimit të projektit. Aktivitetet e projektit mund të kërkojnë marrjen e tokës, duke çuar në mohimin apo kufizimin e qasjes në burimet e tokës, shërbimet dhe lehtësitë sociale të njerëzve. Në këtë rast, planet e veprimit të zhvendosjes, në linjë me OP 4.12 duhet të përgatiten në përputhje me këtë Kuadër Politikash të Zhvendosjes. Faza e parë në procesin e përgatitjes së planeve individuale të zhvendosjes dhe kompensimit është procesi i shqyrtimit për identifikimin e tokës / zonave që janë duke u ndikuar. Planet e zhvendosjes dhe kompensimit do të përmbajnë analizën e vendeve alternative të ndërmarra gjatë procesit të shqyrtimit. Ky seksion përcakton një proces të "harmonizuar" hap pas hapi që projekti do të ndërmarrë për të përcaktuar nëse nënkomponentët do të rezultojnë në zhvendosjen fizike dhe ekonomike, dhe për këtë arsye nëse një plan veprimi zhvendosjeje (PVZH) është i nevojshëm dhe nëse është kështu, si të përgatitet dhe të zbatohet një të tillë. Në mënyrë të veçantë, personat e prekur duhet të informohen në lidhje me qëllimet për përdorimin e vendeve të caktuara. Personat e prekur duhet të bëhen të vetëdijshëm për mundësitë dhe të drejtat e tyre që kanë të bëjnë me zhvendosjen dhe kompensimin, opsionet dhe alternativat specifike të realizueshme teknikisht dhe ekonomikisht për vendet e risistemimit, procesin e propozimit të datave për zhvendosjen dhe kompensimin, normat efektive të kompensimit me kosto të plotë zëvendësimi për humbjen e aseteve dhe shërbimeve, masat e propozuara dhe kostot për ruajtjen apo përmirësimin e standardeve të tyre të jetesës.

E tashmja: Totali i popullsisë së bashkisë është 25301 banorë (e regjistruar në vitin 2011), me një sipërfaqe totale prej 469.25 km². Muret e qytetit datojnë që nga shekulli i tretë. Muret e larta prej guri të kalasë janë ndërtuar nga shekulli i gjashtë deri në të dymbëdhjetë. Gjatë kësaj periudhe, Gjirokastra u zhvillua si një qendër e madhe tregtare e njohur si "Qyteti i argjendtë" apo "Kalaja e argjendtë".

Romani “Kronikë në gur” i shkruar nga shkrimtari shqiptar Ismail Kadare tregon historinë e këtij qyteti gjatë pushtimit italian dhe grek në Luftën e I dhe të II Botërore, dhe shpalos zakonet e popullit të Gjirokastrës.

Qyteti është ndërtuar në shpatin përreth kalasë, i vendosur në një pllajë dominuese. Edhe pse muret e qytetit janë ndërtuar në shekullin e tretë dhe qyteti vetë është përmendur për herë të parë në shekullin e 12, shumica e ndërtesave ekzistuese datojnë që nga shekujt XVII dhe XVIII. Shtëpitë tipike ndërtohen me gurë, muret dhe çatia dhe mund të jetë deri në pesë kate.




Figura 2. Harta e Gjirokastrës

Ka shumë shkallë të jashtme dhe të brendshme që rrethojnë shtëpitë. Mendohet se projektimi i tillë buron nga shtëpitë tipike të fortifikuara në jug të Shqipërisë. Kati i poshtëm i ndërtesës përmban një depozitë të qëndrueshme. Kati i sipërm është i përbërë nga një dhomë për mysafir dhe një dhomë për familjen që përmbajnë oxhak. Për më tepër, katet e sipërme janë për tu akomoduar dhe zgjeruar dhe lidhen me shkallë të brendshme. Që prej anëtarësisë të Gjirokastrës

në UNESCO, një numër i shtëpive janë restauruar, megjithëse të tjerat vazhdojnë të rrënohen. Shumë shtëpi në Gjirokastrë kanë një stil të veçantë lokal nga i cili ka fituar qyteti pseudonimin "Qyteti i gurit", sepse shumica e shtëpive të vjetra kanë kulmet e mbuluara me gurë të sheshtë të veshur. Qyteti, së bashku me Beratin, ishte ndër disa qytete shqiptare të ruajtura në vitet 1960 dhe 1970 nga modernizimi i programeve të ndërtimit. Të dy qytetet fituan statusin e "qytetit muze" dhe janë vende të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.



Figura 3. Pamje nga qyteti i vjetër i Gjirokastrës

Gjirokastra përmban një pazar të vjetër osmane e cila është ndërtuar fillimisht në shekullin e XVII; ajo u rindërtua në shekullin e XIX pas një zjarri. Ka më shumë se 500 shtëpi të ruajtura si "monumente kulturore" në Gjirokastrën e sotme. Xhamia e Gjirokastrës, e ndërtuar në 1757, dominon pazarin.

Gjirokastra është e vendosur midis Ultësirës perëndimore dhe rrafshnaltave të brendshme të Shqipërisë, dhe ka kështu një verë të nxehtë të klimës mesdhetare, edhe pse, (siç është normale për Shqipërinë), reshjet janë më të shumta se zakonisht për këtë lloj klime.

Zonat e qytetit historik (si kryesor dhe mbrojtës) vuajnë nga pabarazitë në nivelin e standardit të infrastrukturës urbane, cilësinë e mjedisit urban dhe pedonale turistike për këmbësorët midis pjesës më të zhvilluar dhe turistike të kalasë, në veri të saj, dhe vendbanimeve të ulëta në kodrat jugore të kalasë.

3.2. Berati “Qyteti i një mijë dritareve”

Berati ndodhet në Shqipërinë qendrore dhe është futur në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s në vitin 2005. Ajo përmban një kështjellë, e njohur lokalisht si Kala, pjesa më e madhe e të cilës është e ndërtuar në shekullin e XIII, edhe pse origjina e saj daton që nga shekulli i IV para Krishtit. Në zonën përreth kalasë ndodhen shumë kisha Bizantine, kryesisht të shekullit të XIII, si dhe disa xhami të ndërtuara gjatë epokës Otomane që kanë filluar që në vitin 1417.



Figura 4. Pamje nga Berati, "Qyteti i një mijë dritareve" (burimi; www.google.al)

Berati ishte një qytet i fortifikuar por i hapur, dhe ka qenë për një periudhë të gjatë kohe e banuar nga artizanët dhe tregtarët. Qendra e saj urbane pasqyron shtëpi tradicionale vendase të Ballkanit, të cilat datojnë në fund të shekullit të XVIII dhe XIX. Kjo traditë i është përshtatur stilit të jetesës së qytetit, me shtëpi në nivele në shpat, të cilat janë kryesisht në nivel horizontal, të përshtatura për përdorimin e bollshëm të dritës së diellit.

Kalaja sheh nga lumi dhe nga qyteti modern, si dhe në pjesën e vjetër të krishterë përtej lumit. Ajo është një zonë e mbrojtur me rrugica të ngushta, shtëpi Turke dhe kisha Ortodokse. Qyteti është i famshëm për arkitekturën historike dhe bukurinë skenike dhe njihet si “Qyteti i Një mijë Dritareve”, si pasojë e shumë dritareve të mëdha të shtëpive të vjetra me pamje nga qyteti.

Kalaja e Beratit në gjendjen e tanishme, edhe pse konsiderohet e dëmtuar, vazhdon të jetë një vend me pamje fantastike. Zona përreth kalasë ka bërë të mundur strehimin e një pjese të konsiderueshme të banorëve të qytetit. Ndërtesat brenda kalasë janë ndërtuar gjatë shek. XIII dhe si pasojë e karakteristikave arkitekturore janë të ruajtura si monumente kulturore.

Popullsia e kalasë ka qenë e krishterë, dhe ka patur mbi 20 kisha (shumica të ndërtuara gjatë shek. të XIII) dhe vetëm një xhami, që përdorej nga batalioni mysliman.

Përshkrimi kontekstual (shih hartën): qendra historike e mbrojtur përbëhet nga tre zona të dallueshme: (i) Kalaja, e mirëruajtur dhe tërheqëse për turistët. Rruga automobilistike për te Kalaja është e ngushtë dhe me cilësi jo të mirë asfalti, e cila përfundon me një parkim të pamjaftueshëm dhe të pa organizuar. (ii) Mangalam: në kodrinën e kalasë, lehtësisht e arritshme me këmbë nga rrugicat e qytetit të Beratit, i cili karakterizohet nga rrugë të ngushta që kanë nevojë për përmirësim; dhe (iii) Gorica, në pjesën jugore të lumit Osum, e vendosur në një zonë të izoluar dhe të ndarë, e karakterizuar nga një nivel i lartë i shkatërrimit urban (rrugët dhe ndërtesat historike). Zonat mbrojtëse në kodër në lindje dhe perëndim të kalasë karakterizohen nga ndërtesa moderne ilegale me vlera vizuale të varfra, duke ndikuar tek pamja e kalasë. Zgjerimi i ulët historik i qendrës së qytetit në perëndim karakterizohet nga zona tranzicioni me përzierje ndërtesash historike dhe moderne. të lidhura me një hapësirë publike që përfshin "Sheshi i bashkëjetesës fetare".




Figura 5. Harta e Beratit

Berati ka klimë mesdhetare. Për shkak të vendndodhjes së tij nën hijen e malit të Tomorrit vera është shumë më e nxehtë se sa pjesa tjetër e Mesdheut.

3.3.Përmeti (40°14'0"V, 20°21'0"L)

Përmeti është një qytet i vogël me një popullsi 10.600 dhe gjendet në zemër të Ballkanit. Ndër të gjitha qytetet e vizituara, ai tregoi një perspektivë më të mirë për t'u bërë një nën-qendër. Atje ka shumë mundësi për ekskursione duke përfshirë pranverën e ngrohtë, ujëvara dhe fshatra.




Figura 6. Pamje nga Përmeti

Gjithashtu, ka mundësi të mira për zhvillimin e rrugëve. Përveç kësaj, ofron mundësi në zhvillimin turistik në drejtim të eko-turizmit.

Ka potencialin për tu konsoliduar si një spirancë në të ardhmen për kufijtë turistikë nga Zagoria.



Figura 7. Pamje nga rajoni i Përmetit

3.4.Saranda, porta e turizmit shqiptar (39°52'30''V, 20°0'36''L)

Saranda është një qytet dhe bashki në qarkun e Vlorës, në jug të Shqipërisë. Ajo është një ndër vendet tërheqëse më të rëndësishme turistike të Rivierës Shqiptare. Ajo është e vendosur në një gji të hapur të detit Jon, në qendër të Mesdheut, rreth 14 km veri-lindje të ishullit të Korfuzit. Popullsia totale është 20.227 (referuar census 2011), me një sipërfaqe totale 58.96 km². Gjithsesi, popullsia sipas zyrës civile është 41.173. Afër Sarandës ndodhet qyteti i antik i Butrintit, një Trashëgimi Botërore e UNESCO-s.

3.5.Ksamili (39°46'0''V, 20°0'0''L)

Ksamili është fshat në rivierën e Shqipërisë së Jugut, dhe pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit. Fshat bregdetar, i ndërtuar në vitin 1966 dhe ndodhet në jug të qytetit të Sarandës. Popullsia sipas census në vitin 2011 ishte 2.994.



Figura 8. Pamje nga fshati Ksamil

Plazhi i Ksamilit dhe bregdeti Jonian i Shqipërisë pjesa veriore është përfshirë në Guardian's 20 si plazhi më i volitshëm për pushime në 2013. Atraksionet kryesore janë pranë ishullit të Ksamilit. Zona bregdetare është e vogël por e pastër.

3.6. Butrinti (39°44'46"v, 20°1'13"l)

Parku Kombëtar i Butrintit është krijuar në Nëntor 2000 dhe shtrihet në jug të Shqipërisë.



Figura 9. Amfiteatri dhe laguna e Butrintit

Ai përfshin 94.24 km² të peizazhit historik, arkeologjik dhe mjedisor. Kufijtë e parkut përfshijnë njësinë administrative të Ksamilit.

Parku, një Trashëgimi Botërore e UNESCO-s, është një nga zonat më të rëndësishme arkeologjike të vendit që përmban objekte të ndryshme dhe struktura të cilat datojnë nga Epoka e Bronzit deri në shekullin e XIX.

Një numër i madh monumentesh janë akoma ekzistuese duke përfshirë dhe muret e qytetit, bazilika e madhe, teatri dhe kështjella veneciane. Përveç kësaj, pjesa arkeologjike është e veshur me bimësi natyrore dhe me një ekosistem kompleks i cili varet në ujërat e freskëta të liqenit të Butrintit dhe kanalit të Vivarit i cili derdh liqenin në detin Jon. Ky është një kombinim i monumenteve historike dhe mjedisit natyror që e bën Butrintin një vend unik, një “peizazh me monumente” i preferuar nga Grand Tourists të shek. XVIII – XIX.

Qeveria shqiptare themeloi Parkun Kombëtar të Butrintit në 2000. Parku kombëtar u bë gjithashtu një Trashëgimi Botërore e UNESCO-s gjatë këtyre viteve, edhe si zonë Ramsar³⁵.

B. Zonat turistike të para-përzgjedhura që do të përfitojnë nga aktivitetet e zbatimit të projektit.

3.7.Laguna e Nartës (40°29'57"N, 19°27'26"E)

Laguna e Nartës shtrihet afër fshatit të Nartës me koordinata gjeografike 40°29'57"N; dhe 19°27'26"E. Ajo është laguna e dytë më e madhe në Shqipëri referuar përmasave dhe ndodhet pak kilometra në veri të qytetit të Vlorës. Laguna është pjesë e zonës së mbrojtur Nartë-Vjosë dhe lidhet me dy kanale të shkurtër me detin Adriatik.

Laguna ka dy ishuj. Më i madhi quhet ishulli Zvërnec. Ura me dërrasa lidh Nartën me ishullin, në të cilin ndodhet një manastir i shek. XIII. Laguna e Nartës e shtrirë në veri të fshatit ka një ekosistem unik.



Figura 10. Ishulli Zvërnec dhe Laguna e Nartës (burimi: www.google.al)



Figura 11. Gjiri i Vlorës, laguna e Nartës dhe Orikumi

Laguna e nartës ka një sipërfaqe 4180 ha dhe është ekosistem natyror me mundësi për zhvillimin e eko-turizmit, vrotimin e shpendëve, peshkimin etj. Ai përfaqëson kompleksin e dytë në Shqipëri për zogjtë e detit. Në Nartë gjenden 195 lloje zogjsh. Në dimër ngrenë fole rreth 48700

³⁵ Ramsar (4 Gusht 2010). “Lista e Lagunave të një rëndësie ndërkombëtare”

zogjsh, 23% e shpendëve ujorë që vijnë në Shqipëri³⁶. Në të njëjtën kohë vijnë shqiponjat e bardha, flamingos, skifterat, hutat e zinj etj.

Zona e Nartës është e njohur për prodhimin artizanal të verës me cilësi të lartë. Në ujërat e lagunës jetojnë lloje të ndryshme peshqish, por më tipiket janë ngjala dhe levreku i Nartës. Bukurinë e Lagunës së Nartës përbëhet nga jeta e saj e pasur detare, diversiteti i specieve bimore, dunat e rërës të shquara të krijuara nga era, delta e lumit Vjosë dhe 195 lloje të shpendëve që numërohen në zonë. Laguna e Nartës është gjithashtu e rëndësishme për eko-turizmin. Ishulli i Zvërnecit është një ishull në kuadër të Lagunës së Nartës në jug të Shqipërisë. Ishulli është gati i gjithi i mbuluar me pisha të larta dhe është vetëm në lindje të një ishulli shumë më të vogël. Ai ka një gjatësi gati 430 m dhe me një gjerësi maksimale 300 m. Ishulli Zvërnec lidhet me pjesën tokësore me një urë druri me një gjatësi 270 m. Ishulli është një atraksion turistik, sepse ruan mirë manastirin bizantin të Zvërnecit të shekullit të XIII-XIV. Në afërsi të ishullit shtrihet fshati që mban të njëjtin emër. Ishulli ka një sipërfaqe prej 9 ha. Manastiri i Shën Mërisë, i njohur gjithashtu si Manastiri i Zvërnecit, është një monument i rëndësishëm kulturor në ishullin Zvërnec në Lagunën e Nartës. Kisha Bizantine e ndërtuar në shekullin e XIII, është oazi shpirtëror për të krishterët e kësaj zone. Kisha e Shën Marisë është një vend i bukur i adhuruar, paqësorë dhe i rrethuar nga jeshillëk.

Vjosë-Nartë mbrohet si zonë peizazhi, e pasur në ligatina dhe shpendë ujorë, që ndodhen në Qarkun e Vlorës me madhësi aktuale 19,738.00 ha. Kufijtë gjeografike janë:

- a) Grykëderdhja e lumit Vjosë (4357230.70L / 4503383.01V), ndjek rrjedhën e lumit Vjosë në pikën me koordinata (4374598.35L / 4497984.40V) ;
- b) Lindje: Pika me koordinata (4374598.35L / 4497984.40V), ndjek mbrapa kodrave kuotën e tre Vëllazërisë 105.0 m, shtegun e këmbësorëve, dhe në majë Çiplakun (235.1 m), kuotat 246.0 m 221.0 m & 227.6 m, kalon në afërsi të fshatit Kërkovë, majën e Mutrevës (222.6 m), kuotat 196.0 m, fshatin Bestrovë, kuotat 204.0 m, 202.0 m, 164.0 m, 160.8 m, duke kaluar rrugë për tek Muezini (4371353.76L / 4484988.27V);
- c) (4371353.76L / 4484988.27V), duke kaluar pranë minierës së kripës, Kavallonës edhe në pikën e takimit me detin Adriatik (4367602.48L / 4484771.87V);
- d) Perëndimi: Pika e takimit me Detin Adriatik (4367602.48L / 4484771.87V) dhe vazhdon përgjatë bregdetit deri në grykën e lumit Vjosë.

³⁶ <http://www.albania.al>

3.8. Orikumi

Orikumi (Orikos) është një ish bashki në qarkun e Vlorës. Sipas reformës së qeverisë vendore 2015, ai u kthye në një nënndarje (pjesë) të bashkisë së Vlorës. Emrin e ka marrë nga qyteti antik i Orikumit, i cili ndodhet rreth 4 km në perëndim të Orikumit të sotëm. Popullsia sipas Censurit të vitit 2011 ishte 5503 banorë. Afër qytetit modern ndodhet e vetmja marinë në Shqipëri.



Figura 12. Orikum: Parku arkeologjik dhe shpella e Haxhi Aliut

Pozicioni i tij gjeografik e kanë kthyer në një port të rëndësishëm dhe në një pikë tregtare në bregdetin Adriatik. Orikumi ka qenë i rëndësishëm edhe për ushtrinë. Ai u përdor nga romakët si një bazë mbrojtëse në luftërat kundër ilireve, dhe po ashtu në shekullin e III para erës sonë kundër maqedonasve, të cilët e pushtuan më vonë në vitin 214 para erës sonë. Jul Çezari e ka përdorur këtë zonë si kamping për ushtrinë derisa Pompeius Magnus i pushtoi. Duke qenë pjesë e kaq shumë ndikimesh kulturore, Orikumi është kthyer në një qendër urbane të rëndësishme. Kjo vihet në dukje nga rrënojat e shumta arkeologjike, të tilla si platforma e një orkestre dhe teatri i vogël me kapacitet mbajtës prej 400 spektatorësh.

Orikumi është një zonë arkeologjike e një rëndësie tepër të lartë. Sipas specialistëve, për nga rëndësia, ai mund t’ia kalojë edhe Butrintit. Laguna e Orikumit gjendet në jug të gjirit të Dukatit (Vlorë), në një zonë të kufizuar ushtarake dhe lidhet me detin nëpërmjet një kanali.

Vetëm 130 hektar nga Laguna e vjetër e Orikumit (Pasha-Limani) ka mbetur në ditët e sotme. Rreth 25 vite më parë, punimet e kullimit dhe ndërtimi i një dige thanë rreth 400 hektar nga laguna e mëparshme. Shumë kënetë agrokulturore janë të braktisura aktualisht, ose përdoren për kullotje dhe pjesa më e madhe e e tokave dikur të mbjella, sot është “pushtuar” nga bimësia.

3.9. Gadishulli i Karaburunit

Brigjet veriore dhe perëndimore kanë një gjatësi prej 14 km, duke filluar nga Kepi i Karlovecit deri në Kepin e Gjuhëzës dhe duke u shtrirë në bregun e Bristanit.

Shpatet e gadishullit të Karaburunit janë tepër të pjerrët në anën perëndimore, duke kulmuar në pjesën qendrore. Ana perëndimore karakterizohet nga shkëmbinj të lartë, të cilët shkojnë thellë në ujë dhe që përbëhen nga kanione me plazhe me rërë të përherëshme. Këta shkëmbinj bien pre e erozionit dhe tek ta ndodhen shpella të shumta nëpër të cilat rrjedh ujë i ëmbël.

Bimësia dominohet nga shkurre të ulëta dhe të rralla në të dyja anët e vargmalit, si dhe nga disa bimë halore ose pemë të tjera. Mjedisi nënujor bregdetar përgjatë anës perëndimore është i diversifikuar dhe relativisht i bollshëm, dhe është i organizuar sipas disa zonave detare ekologjike zbritëse. Kanionet dhe shpellat e gadishullit, shpesh të pa-aksesueshme nëpërmjet tokës, shërbejnë si habitate ideale për luanët e detit. Zona përbën interes për peshkimin.

Karaburun-Sazan është një Park Kombëtar Detar i pozicionuar në Vlorë. Sipërfaqja e përgjithshme e këtij parku është 12 428 hektar, e ndarë në:

Zona në det të hapur e gadishullit të Karaburunit me një sipërfaqe prej 9'848.95 hektarësh. Zona afër gadishullit të Karaburunit, kepi i Shën Vasilit deri në zonën e Langadhës, ishulli i Sazanit me një distancë prej 1 milje detare, është identifikuar nga ekspertet vendas dhe të huaj si trashëgimi natyrore me vlerë shumë të lartë.

Rajoni është i pasur në shumëllojshmëri peizazhesh nënujore, habitatesh dhe specieve të florës dhe faunës detare; ai dallohet si vendi që ofron strehë, ushqim dhe shumim të specieve të mjedisit kombëtar, rajonal dhe global. Ai është gjithashtu një vend i përshtatshëm për rritjen e shumë bimëve ose organizmave shtazorë nënujorë, duke filluar që nga algat detare, sfungjerët, molusqet, krustacet, koralet e kuqe, reptilët, gjitarët dhe habitatet e mundshme për luanët e detit Mesdhe.

Një prej shenjave dalluese të biodiversitetit të kësaj zone janë livadhet nënujore të Posidonias (Posidonia Oceanica), të cilat cilësohen si specie e përkeqësuar në detin Mesdhe. Qëllimi i tyre lidhet me natyrën dhe përbërjen e shtratit të detit, veçoritë e ujit, të tilla si transparenca, pastërtia, etj. Të cilat dallohen më së miri në gadishullin e Karaburunit dhe ishullin e Sazanit.

Kjo zonë është e banuar ose vizitohet nga specie të rrezikuara botërisht, të cilat renditen në konventat ndërkombëtare në të cilat është aderuar Shqipëria, të tilla si disa lloje peshqish, peshkaqenësh, breshkat e ujit, delfinët dhe luanët e detit (*Monachusmonachus*).

Kufijtë e dixhitalizuar përfshijnë:

- a. Në veri: Pika 1 (në det të hapur), me distancë 1 milje detare (1852 m) nga Kepi i Gjuhëzës, me koordinata 4353018.48 V 4478005.72 L, në pikën 2 (det), me distancë 1 milje detare (1852 m) nga Kepi i Shën Vasilit, me koordinata 4477378.71 4363780.19 V L;
- b. Në lindje: Pika 2 (det), me distancë 1 milje detare (1852 m) nga gjiri i Shën Vasilit, me koordinata 4363780.19 V 4477378.71 L dhe më pas vazhdon përgjatë bregut detar nga Kepi i Shën Vasilit, Kepi i Dim Kushtës, Kepi dhe gjiri i Shën Gjonit, Kepi i Gjuhëzës, duke ndjekur malin bregdetar perëndimor të Karaburunit, gjirin e Gjinarës, bishtin e Malit, faqen e Langadhësnë pikën 3, me koordinata 4449696.28 4379221.15 V L;
- c. Në jug: Pika 3, me koordinata 4449696.28 4379221.15 V L, në pikën 4 (në det të hapur), me distancë 1 milje detare (1852 m) nga Langadha, me koordinata 4448193.75 4378104.94 në L;
- d. Në perëndim: Pika 4 (në det të hapur), me distancë 1 milje detare (1852 m) nga Langadha, me koordinata 4378104.94 dhe 4448193.75 L dhe ndjek izobatin në pikën 1 (në det të hapur), me distancë 1 milje detare (1852 m) nga gjiri i Gjuhëzës, me koordinata 4478005.72 4353018.48 L.

3.10. Nga Karaburuni në Dhërmi

Vija bregdetare përgjatë Rrëzës së Kanalit vazhdon për 30 km dhe shtrihet nga Gjiri i Bristanit deri në Dhërmi. Rrëza e Kanalit është e ngjashme me Gadishullin e Karaburunit për sa i përket florës dhe faunës detare. Zona kufizohet nga një gjatësi e konsiderueshme e malit të Cikës, e shtrirë paralelisht me bregdetin, e përbërë nga disa gjire, shkëmbinj dhe plazhe me rërë të përzier/gurë në breg të detit. Parku kombëtar i Llogarasë përfshihet në këtë zonë. Më tej përgjatë bregut ndodhet lugina e Palasës e krijuar nga erozioni dhe rrëketë e prurjeve pranverore; dhe Dhërmiu, i karakterizuar nga dy rrëke, njëri i përhershëm dhe tjetri i krijuar nga prurjet pranverore, të cilat kanë ndërtuar dy lugina të vogla në pjesën jugore të luginës më të madhe të Palasës afër detit. Rrjedha e Dhërmiut është e krijuar nga prurjet pranverore dhe ka krijuar një çarje të thellë në peizazh, duke shkaktuar krijimin e një kanioni dhe të shumë shkëmbinjve përgjatë rrëkesë.

Në shpatet përgjatë detit bimësia në pjesën më të madhe të vendeve është e ngjashme me atë të gadishullit të Karaburunit, e ulët, e rrallë dhe me shkurre, ndërkohë që më në brendësi të tokës ka zona më bimësi të ulët dhe halore.

Vija bregdetare përgjatë bregut dallohet për trashëgimi kulturore me shumë vlerë, duke përfshirë: afreske dhe skulptura nga periudha e Kristianizmit, mbishkrime nga periudha Helenistike dhe guroret antike të Gjirit Gama.

3.11. Nga fshati i Dhërmiut në Porto Palermo

Profili bregdetar nga Dhërmiu në Porto Palermo përfshin disa mjedise. Relievi bregdetar është më i butë, me pjerrësi në det, me përjashtim të disa pjesëve shkëmbore. Mjedisi nënujor karakterizohet nga një ngritje e konsiderueshme në afërsi të bregut, e përbërë nga plazhe me zhavorr dhe rërë. Livadhet me barishte deti të tipit *Posidoniaoceanica* dominojnë zonat e cekëta.

Kanioni i Vunoit është shumë mbresëlënëse; habitatit i tij i veçantë karakterizohet nga një biodiversiteti i lartë. Përgjatë kanionit, në një shpellë janë gjetur mbetje prehistorike (Epoka e hekurit). Kanioni shtrihet në det në një grykë të ngushtë, duke arritur pikën kulmore në një plazh të bukur të veçantë.

Porto Palermo përfshihet në zonën e peizazheve të mbrojtura, i konsideruar si shumë atraktiv dhe si një pikë potenciale për zhvillimin e turizmit dhe sporteve ujore. Është një zonë që ofron strehim të natyrshëm, në të cilën është vendosur vendbanimi antik i Panormis-it, si dhe ka potencial për të qenë bazë detare. Kështjella e Ali Pashës, muzeumi dhe disa ndërtesa ushtarake mund të përdoren si pika informacioni dhe edukative. Baza e nëndetësës me tunelin e saj rreth 800 m të gjatë, mund të jetë atraktive për turistët, ashtu si dhe mbetjet arkeologjike (amforat) e shekullit të II para Krishtit, që gjenden në këtë gjiri.

3.12. Nga Kepi i Qeparoit në Kepin e Qefalisë

Kepi i Qeparoit deri tek Kepi i Qefalisë përfshin 20 km vijë bregdetare, midis rrethit të Vlorës dhe atij të Sarandës. Kjo pjesë e bregdetit karakterizohet nga pasimi i epokave të ndryshme gjeologjike që kanë krijuar shtatë peizazhe: (1) Kepi shkëmbor i Qeparoit; (2) Qeparo; (3) Rrafshina e Borshit me plantacionet e mëdha të ullinjve; (4) Bregu i ngushtë i Lukovës, me shtresa të mëdha gëlqerore; (5) Bregu i gjerë i Kepit të Qefalisë; (6) Plazhet e Kakomesë; (7) dhe shkëmbinj të vertikali të Gjirit të Pogajetës, në veri të kepit të Qefalisë.

Plazhet me rërë të bardhë janë të përhershëm përgjatë të gjithë rajonit dhe shtrihen në mjedisin detar deri në 20 m thellësi.

3.13. Nga Kepi i Qefalisë në Kepin e Stillos

Vija bregdetare nga Kepi i Qefalisë në atë të Stillos nuk është po aq mbresëlënëse sa ajo e rajoneve të përmendura më sipër. Ajo ndahet në disa pjesë: (1) nga kepi i Qefalisë në Sarandë, shkëmbinjtë janë të ulët dhe të përkulur, duke u mbyllur në plazhe të vegjël me zalle; (2) zona që përfshin qytetin e Sarandës; (3) zona në jug të qytetit të Sarandës; (4) plantacionet e braktisura dhe zonat e shpyllëzuara në afërsi të Ksamilit; (5) ishujt e Ksamilit, me plazhe të vogla me rërë dhe pyjet e skalitura nga era; (6) kepi i Shkallës me shkëmbinj të ulët dhe plazhe të vogla të veçuara; (7) zona e liqenit të Butrintit është një prej habitateve më të pasura në bregdetin jugor; (8) kodrinat në jug të liqenit të Butrintit, me shtrate të ulët lumenjsh, plazhe të veçuara dhe ligatina; dhe (9) ishulli i paprekur dhe shkëmbor i Stillos.

3.14. Syri i Kaltër (39°55'25"V, 20°11'34"L)

Syri i Kaltër është një burim ujor dhe një fenomen natyror afër Muzinës në Vlorë, Shqipëri. Uji i pastër ngjyrë blu i lumit, një atraksion i njohur turistik, rrjedh nga një burim mahnitës më shumë se 50 metra i thellë. Zhytësit janë zhytur deri në 50 metra thellësi, por është ende e paqartë thellësia reale e gropës karstike³⁷.

Ai është burimi fillestar i ujit të lumit të Bisticës, 25 km i gjatë, i cili përfundon në detin Jon në jug të Sarandës. Burimi është një monument natyror dhe ka një normë shkarkimi prej 18400 l/s. Zona pasuese (180 ha) është një rezervuar natyror dhe karakterizohet nga pemët e lisit dhe panjës. Në vitin 2004 burimi u tha përkohësisht.

³⁷https://en.wikipedia.org/wiki/Blue_Eye,_Albania

A: Shembull i nje Plani i Menaxhimit Social dhe Mjedisor (“Rehabilitimi i rruges me kalldrem te Kalase “Mihal Komneno” dhe i pikes panoramike “Tabja”)

A. Plani i masave zbutese sociale dhe mjedisore

Faza	Ceshtja	Masat zbutese	Kosto (EUR)		Pergjegjesia institucionale		Komente
			Instalimi	Zbatimi	Instalimi	Zbatimi	
<u>Parandertimore</u>	<i>Pastrimi i vendit te punes nga materialet inerte, dherat; largimi i antenes ekzistuese dhe nderteses se braktisur</i>	Ne konsultim me Bashkine Berat, jep nje metode te pershtatshme per riciklimin e materialeve te ndertimit dhe metalet per skrap	-	7,413	FSHZH/Bashkia Berat	Kontraktori	Sic jepet ne preventiv
<u>Parandertimore</u>	<i>Materialet e marra nga vende te jashteligjshme apo te paautorizuara mund te shkaktojne presion mbi burimet natyrore</i>	Perdor gurore te licensuara ekzistuese Kerkese per aprovim zyrtar apo license te vlefshme shfrytezimi	-	-	Gurore	Kontraktori duhet te kete te gjitha lejet	Nuk do te perdoret asphalt gjate rehabilitimit. Gure specifike do te perdoren ne perputhje me projektin teknik
<u>Ndertimi</u>	<i>Pluhurat e ngritura gjate transportit te materialeve te gurit</i>	Te laget ngarkesa ose te mbulohet	-	70/muaj	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	To be specified in bid documents
<u>Ndertimi</u>	<i>Pluhurat e ngritura gjate punimeve te ndertimit</i>	te laget kantieri dhe venddepozitimet e materialeve	NA	100/muaj	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	To be specified in bid documents.
<u>Ndertimi</u>	<i>Ndotja e ajrit dhe zhurmat prej makinerive ne terren, transporti dhe ndjegja e motoreve ne kantier</i>	Te mos lejohen makinerite te ndezura ne kantier Perdorni makineri te testuara dhe te pershtatshme Nuk lejohet djegja e hapur apo e mbyllur ne asnje menyre ne kantier	Minimal	Minimal	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	
<u>Ndertimi</u>	<i>Shqetesim nga zhurmat per njerezit dhe kafshet</i>	Te kontrollohet qe zhurmat e cliruara te mos kalojne normat e vendosura ne rregullore (85 dB per mjediset urbane, jashte).	minimal	50/muaj	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	To be specified in bid documents.
<u>Ndertimi</u>	<i>Trafiku qe mund te krijojte zhurma, clirim nga djegja, ngarkim trafiku perreth kantierit</i>	Te kryhet transporti i materialeve ne oret me trafik minimal. Te perdoren rruge alternative per te	NA	minimal	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	

Faza	Ceshtja	Masat zbutese	Kosto (EUR)		Pergjegjesia institucionale		Komente
			Instalimi	Zbatimi	Instalimi	Zbatimi	
		minimizuar ngarkesen e trafikut. Punimet duhet te kryhen ne menyre te alternuar njehere ne njeren ane te rruges, njehere ne tjetren me qellim qe te lihet rruga e lire per kalimntaret.					
<u>Ndertimi</u>	Shqetesimi i trafikut gjate aktiviteteve te ndertimit	Plani i menaxhimit te trafikut me masa ate pershtatshme per te drejtuar trafikun dhe te lehta per t'u zbatuar; ne bashkepunim me autoritetet lokale, perfshire policine e trafikut	Sic specifikohet ne dokumentat e tenderit	minimal	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	Masat perfshihen ne Planin e Menaxhimit te Trafikut (Dokumentat e tenderit)
<u>Ndertimi</u>	Siguria e kembesoreve dhe mjeteve	Ndricim i pershtatshem dhe shenja te mirepercaktuara te sigurise. Njoftim ne media per fillimin e punimeve	Sic percaktohet ne dokumentat e tenderit	minimal	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	
<u>Ndertimi</u>	Ndotja e ujit dhe e tokes nga depozitimi i papershtatshem i materialeve, menaxhimi dhe perdorimi i makinerive te ndertimit	Organizo dhe mbulo zonat e depozitimit te materialeve; riperdor token per rimbullimin e sistemit te kullimit, izolo zonat e larjes se materialeve duke zgjedhur zona per larje qe nuk rrjedhin direkt ne uje; instalo pajisje per kontrollimin e rrjedhjeve. Siguro menaxhim te mire te mbetjeve me qellim qe te parandalohet ndotja. Vendos nje mekanizem per kontrollin e rrjedhjeve dhe per nderhyrje emergjente per kontrollin e rrjedhjeve.	Sic percaktohet ne dokumentat e tenderit	50 / muaj	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	Rekomandohet qe guret dhe materialet e tjera qe do te largohen, te riperdoren dhe riciklohen sipas keshillave te Institutit te Monumenteve te Kultures dhe Bashkise.
<u>Ndertimi</u>	Ndotja e ujit dhe e tokes nga depozitimi i papershtatshem i mbetjeve	Largo mbetjet ne vendet e pershtatshme te mbrojtura nga rrjedhjet, ne bashkepunim me Bashkine Berat. Per depozitim e	minimal	100/muaj pervec 3,840 EUR te	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	Shumica e mbetjeve te gjeneruara mund te riciklohen

Faza	Ceshtja	Masat zbutese	Kosto (EUR)		Pergjegjesia institucionale		Komente
			Instalimi	Zbatimi	Instalimi	Zbatimi	
		perkohshem te mbetjeve, zgjidh nje zone me siperfaqe te papershkueshme, sa me larg nga vija ujore. Mblidh dhe menaxho ne menyre te pershtatshme te gjitha mbetjet, perfshire materialin e germuar qe mund te largohet ne vende te miratuara nga Bashkia.		parashikuara nga preventiv			
<u>Ndertimi</u>	Ndotja potenciale e tokes dhe ujit nga mirembajtja e papershtatshme dhe furnizimi i pajisjeve	Menaxhimi i pershtatshem i lubrifikuesve, karburantit dhe tretesve me ane te depozitimit te sigurte; te sigurohet furnizimi me karburant dhe te mirembahen pajisjet; te mblidhen te gjitha mbetjet dhe te largohen ne vendin e caktuar. Ne rast rrjedhjeje, toka e ndotur duhet te mblidhet dhe te largohet si mbetje e rrezikshme. Mbetjet duhet te mblidhen ne konteinere te vecante. Nevojitet te kete nje mekanizem te kontrollit te rrjedhjeve dhe te kete plan emergjence per kontrollin e rrjedhjeve.	minimal	minimal	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	Bashkia Berat duhet te jape leje me shkrim per nje vend te pershtatshem depozitimi te mbetjeve perpara fillimit te punimeve te ndertimit
<u>Ndertimi</u>	Nderhyrje ne skemat ekzistuese te kullimit e shkarkimit te ujerave duke krijuar ujera te ndenjura	Ne perputhje me projektin teknik, te ruhet gjendja natyrale e shkarkimit	minimal	minimal	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	
<u>Ndertimi</u>	Shendeti dhe siguria ne pune e punetoreve	Te pajisen punetoret me instruksione mbi sigurine ne pune dhe me pajisje mbrojtese (syze, maska, helmata, cizme, etj; sigurimi i trafikut; pajisje te emergjences mjekesore te jene te pranishme ne kantier).		minimal	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	

Faza	Ceshtja	Masat zbutese	Kosto (EUR)		Pergjegjesia institucionale		Komente
			Instalimi	Zbatimi	Instalimi	Zbatimi	
<u>Ndertimi</u>	Ndikimi mbi vegjetacionin, pemet, lendinat, etj	Pastrimi i vegjetacionit duhet te mbahet ne minimum dhe te kryhet zevendesimi i mbjelljeve, ne perputhje me masat per mbrojtjen habitateve dhe brigjeve te lumit.	NA	Ne perputhje me rregulloret kombetare, per 1 peme qe pritet, duhet te mbillen 3.	Kontraktori i ndertimit; Drejtoria e Pyjeve		
<u>Ndertimi</u>	Gjetjet rastesore te objekteve me interes kulturor dhe historik	Ne rast te gjetjes se objekteve rastesore gjate germimeve dhe punimeve te pergjithshme, punimet do te ndalojne menjehere, zona do te sigurohet dhe autoritetet perkatese do te informohen brenda 3 ditesh. Autoritetet do te kene 15 dite ne dispozicion per t'u pergjigjur dhe per te detajuar masat qe duhet te merren per te vazhduar me punimet.		Ne rast te gjetjeve rastesore, pronari i projektit do te paguaje sipas ligjit shqiptar per te gjitha investigimet	Kontraktor, FSHZH, Bashkia Berat		Legjislacioni shqiptar detajon te gjitha veprimet ne rast te gjetjeve rastesore.
<u>Ndertimi</u>	Kushtet e punes dhe punesimit <i>a)Parandalimi i semundjeve dhe vizitat mjekesore</i> <i>b)Krijimi i vendeve te reja te punes</i> <i>c)Akomodimi i punonjesve</i> <i>d)Siguria e punonjesve ne kantier</i>	a) Ekzaminime shendetesore parandaluese per punonjesit, trainime per parandalimin e semundjeve, edukimi/informimi te lidhura me SST b) Informimi i popullsise lokale per vendet e lira te punes. Perfshirje maksimale e punetoreve lokale. c) Nevojat per akomodim do te vleresohen ne te gjitha kampet e punetoreve. Te sigurohet akomodim standard. d) Te pajisen punonjesit me instruksione per sigurine dhe me pajisje mbrojtese (syze, maska,	Sic specifikohet ne preventiv	minimal	Kontraktori i ndertimit, FSHZH	Kontraktori i ndertimit	eshte kerkese ligjore pajisja me mjete mbrojtese e punetoreve

Faza	Ceshtja	Masat zbutese	Kosto (EUR)		Pergjegjesia institucionale		Komente
			Instalimi	Zbatimi	Instalimi	Zbatimi	
		helmata, cizme, etj). b) Trainimi i punetoreve te ndertimit c) Mekanizmi i ankimimit per punonjesit per te ngritur ceshtje te arsyeshme ne lidhje me punen (komente ose ankesa)					
<u>Funksionim/mirembajtja</u>	Shqetesim nga zhurmat per popullsine lokale dhe punetoret shkaktuar nga punimet e mirembajtjes ne rruge, ndricim dhe piken panoramike	te kufizohen aktivitetet gjate dites (ose sic bihet dakord me autoritetet lokale).	Minimal	minimal	Kontraktori i mirembajtjes/NjQV	Kontraktori i mirembajtjes/Nj QV	Te specifikohet ne dokumentat e kontrates se mirembajtjes – specifikimet teknike per realizimin e punimeve te mirembajtjes, ne bashkepunim me Institutin e Monumenteve te Kultures. Rekomandohet qe punimet e mirembajtjes nga autoritetet pergjegjese, sic vendoset ne bashkepunim me Institutin e Monumenteve te Kultures.

B: Shembull i nje Plani i Monitorimit Mjedisor dhe Social (“Rehabilitimi i rruges me kalldrem te Kalase “Mihal Komнено” dhe i pikes panoramike “Tabja”)

Faza	Cili aktivitet/ndikim do te monitorohet?	Ku do te monitorohet?	Si do te monitorohet/tipi i pajisjeve te monitorimit	Kur do te monitorohet? (frekuenca e matjeve ose vijimesia)	Pse do te monitorohet parametri? (Opsionale)	Indikatorët	Kosto		Pergjegjesia institucionale	
							Vendosja	Funksionimi	Vendosja	Funksionimi
Parandertimore	Pajisja me leje apo licence te vlefshme per gurore dhe materiale te tjera	Ne vendndodhjen e gurores	Inspektim i te gjitha dokumenteve te nevojshme	Perpara fillimit te punes	Per te siguruar perdorim te qendrueshem te materialeve	Pajisja me miratim zyrtar apo licence te vlefshme	-	-	Operatori i gurores	Operatori i gurores
<u>Ndertimi</u>	Mbulimi ose lagia e materialeve te transportuara qe mund te gjenerojne pluhur, si guret, rera ose zhavorri	Vendi i punes – cdo pajisje	Supervizim	Ne vijimesi	Per te evituar ndotjen e ajrit	Kamiona te mbuluara. Raportet e inxhinierit supervisor	-	minimale	FSHZH	Supervizori
<u>Ndertimi</u>	Ngarkese ne kantier, shqetesim i trafikut, ankesa per menaxhimin e trafikut	Ne kantier	Supervizim pamor	Rregullisht nga supervisor	Per te siguruar shqetesim minimal per trafikun	Numri i ankesave te marra		minimal	a) FSHZH	Supervizori
<u>Ndertimi</u>	Dentim i struktures se tokes, rreshqitje e bankinave	Kantier	Supervizim	Inspektime te palajmeruara gjate punimeve, pas shirave te rrembyeshem	Per te siguruar ndikime minimale ne toke	Rreshqitje dherash, erosion, bankina te dentuara	-	minimal	FSHZH	minimal
<u>Ndertimi</u>	Shqetesime zhurmash per njerezit dhe kafshet, si dhe punetoret ne kantier	Kantier, shtepite me te aferta	Mates zhurmash, inspektim	Njehere per secilen makineri kur fillojne punimet dhe pas cdo ankese	Siguro perputhjen e punimeve me mjedisin shendetin dhe sigurine	Nr i ankesave te regjistruara	minimal	minimal	FSHZH	Supervizori
<u>Ndertimi</u>	Parametrat e ndotjes se ajrit, pluhurave dhe grimcave	Ne kantier	Marrje mostrash	Pas ankesave	Per te siguruar emetime minimale gjate punimeve	Nr i ankesave te regjistruara, raportimet tek autoritetet mjedisore	minimal	100/muaj	FSHZH	Supervizori
<u>Ndertimi</u>	Cilesia e ujit dhe e dheut (grimca ne suspension, vajra dhe graso)	Ne dhe prane kantierit	Marrje mostrash	Pas ankesave	Per te evituar rrjedhjet gjate punimeve	Nr i ankesave te regjistruara	minimal	minimal	FSHZH	Supervizori
<u>Ndertimi</u>	Sinjalistika e vendosur	Ne dhe prane kantierit	Vizualisht nga supervisor	Rregullisht	Per te siguruar	Nr. i shenjave	minimal	FSHZH	Supervizori	minimal

Projekti për Kuadrin Menaxherial Mjedisor dhe Social të Zhvillimit të Integruar Ekonomik Urban

					vendosjen e qarte te shenjave te sigurise					
<u>Ndertimi</u>	Largimi i mbetjeve ne vendin e autorizuar	Ne kantier per mbledhjen ne kohe dhe largimin per tek vendi i depozitimit	Percaktimi zyrtar nga NjQV	Perpara fillimit te punimeve	Per te siguruar menaxhim te mire te mbetjeve	Percaktimi nga Bashkia, sasia e mbetjeve qe do te largohen	minimal	FSHZH	Supervizori	minimal
<u>Ndertimi</u> / <i>SIguria e punetoreve</i>	Pajisjet mbrojtese (syze, maska, helmeta, cizme, etj. Organizimi i trafikut)	Kantier	Inspektime	Inspektime te palajmeruara gjate punimeve		Nr i aksidenteve ne pune te regjistruara	-	minimal	Supervizori, FSHZH	Supervizori
<u>Ndertimi</u> / <i>Dentimi i, pemeve, lendinave, etj.</i>	Humbje e/ndikim ne vegjetacion	Kantier	Supervizim, raporte fotografike	Gjate furnizimit me materiale dhe ndertimit		Raporte te vizitave te shpeshta te ekspertit te mjedisit		minimal	Supervizori, FSHZH	
<u>Ndertimi</u> / <i>Gjetja rastesore e objekteve</i>	<i>Pronat kulturore</i>	Kantier	Vizitat e ekspertit nga IMK, inspektime te rregullta	Ne vijimesi		Katalogu i objekteve te gjetura, perfshire dokumentim fotografik dhe me shkrim	Duhet te jete pjese e aktiviteteve te rregullta	minimal	Supervizori, FSHZH, IMK	Supervizori, IMK, FSHZH

Projekti për Kuadrin Menaxherial Mjedisor dhe Social të Zhvillimit të Integruar Ekonomik Urban

Funksionimi <i>Siguria e mjeteve dhe kembesoreve kur nuk ka aktivitete ndertimi</i>	Vizibiliteti	Ne dhe prane kantierit	Observim	Nje here ne jave ne darke		Numri i shenjave paralajmeruese, numri i aksidenteve te regjistruara	minimal	minimal	LGU	Kontraktori i mirembajtjes
Shtim i mbetjeve urbane per shkak te rritjes se numrit te vizitoreve ne vend	Ndikim visual	Ne apo prane vendit te punes	Vizita ne kantier dhe komunikim me autoritetet lokale	Nje here cdo dy dite nga NjQV per arsye mirembajtje	Per arsye estetike	Mungesa e mbetjeve ne toke, kosha te zbrazeta	Duhet te jete pjese e aktiviteteve qe kryhen rregullisht nga NjQV		NjQV	NjQV
a)Parandalimi i semundjeve dhe ekzaminimet shendetesore b)Krijimi i vendeve te reja te punes c)Akomodimi i punonjesve d)Siguria e punonjesve ne kantier	1) Ekzaminime shendetesore per punonjesit, 2) Trainim per parandalimin e semundjeve, perfshire SST 1)Informimi i popullsisë lokale per vendet e punes 2)Perfshirja e punetoreve lokale 3) Vleresim i nevojave per akomodim. 4) Standardet e akomodimit 1) Instruksione mbi sigurine dhe pajisje mbrojtese (syze, maska, helmeta, cizme, etj). Organizimi i sigurte i trafikut. 3) Mekanizmat e ankimimit te jene te disponueshem. Pike fokale per ankimimet.	Ne apo prane kantierit	Vizita ne terren dhe komunikim me punonjesit dhe komunitetin	Nje here ne jave nga FSHZH	Per te siguruar zbatuesmerin e korrekte te kriterëve per shendetin dhe sigurine	Punonjesit te qarte dhe te informuar mbi procedurat, te pajisur me mjete mbrojtese	Duhet te jete pjese e aktiviteteve rutine	Minimal	FSHZH, supervisor, kontraktor	supervisor, kontraktor

Aneksi 6. Procesi i Shqyrtimit Social


Tabela e Ndikimeve të mundshme të Zhvendosjes së Pavullnetshme

Nr	Pyetje mbi Ndikimin e Zhvendosjes së Pavullnetshme	Po/Jo	Panjohur	Detaje/Shënime
1	A do përfshijë ndërtime të reja fizike ndërhyrja?			
2	A përfshijnë ndërhyrja përmirësimin apo rehabilitimin e objekteve lehtësuese ekzistuese fizike?			
3	A mundet që ndërhyrja të shkaktojë ndonjë dëm të përhershëm apo humbjes të strehimit, aktiveve të tjera, përdorimin e burimeve?			
4	A është vendi i zgjedhur për këtë punë i lirë nga pengesat dhe a është në posedim të qeverisë / komunitetit?			
5	A kërkon kjo ndërhyrje e projektit përvetësim të tokës private?			
6	Nëse vendi është në pronësi private, a mund të blihet kjo tokë nëpërmjet një zhvendosjeje të negociuar?			
7	Nëse ngastra e tokës duhet të merret, a janë madhësia aktuale e ngastrës dhe statusi i pronësisë të njohur?			
8	A janë këta pronarë të tokave të gatshëm për të dhuruar vullnetarisht tokën e kërkuar për këtë nën-projekt?			
9	A do të humbasin pronarët e prekur të tokës më shumë se 20% të tokës zonën e tyre / strukturës, për shkak të dhurimit?			
10	A gjendet toka për mobilizimin e materialeve të ndërtimit ose transportin për punën ndërtimore në dispozicion në ngastrën ekzistuese (Ana e djathtë e rrugës)?			
11	A ka njerëz pa titull pronësie që jetojnë/bëjnë biznes në vende e propozuara të projekteve që do të përdoren për punë ndërtimi? A do të ketë ndonjë ndikim të përkohshëm?			
12	A ka ndonjë mundësi për të lëvizur jashtë, në afërsi të biznesit/aktivitetit tregtar/jetesës të personave gjatë ndërtimeve?			
13	A ka ndonjë zhvendosje fizike të personave për shkak të ndërtimeve? A përfshin ky projekt zhvendosjen e ndonjë personi? Nëse po, jepni detaje.			
14	A do të ketë humbje / dëmtim të tokave bujqësore, të korrura në rritje, pemë?			
15	A do të ketë humbje të të ardhurave dhe kushteve jetesës?			
16	A do të humbasin njerëzit përgjithmonë ose përkohësisht aksesin në lehtësira, në objekte, shërbime, apo burime natyrore?			
17	A ka ndodhur ndonjë përvetësim i mëparshëm i tokës dhe toka të jetë identifikuar tashmë?			

Tabela e Përmbledhjeve të Ndikimeve të Zhvendosjes së Pavullnetshme

Nr	Njësia e Ndikimit	Aktiviteti Nr. ____
1	Tokë Private e Kërkuar (m ²)	
2	Nr i Pronarëve që humbasin më shumë se 20% të tokës së tyre	
3	Tokë në pronësi shtetërore e kërkuar (m ²)	
4	Tokë Pyjore e kërkuar (m ²)	
5	Nr i njësive ekonomike familjare të prekura	
6	Nr i dyqaneve të prekura	
7	Nr i strukturave të tjera të prekura	

Aneksi 7. Hapat kryesorë në Përgatitjen e Planit të Veprimit për Zhvendosje



Aneks 8. Skema dhe Përmbajtja e Mundshme për PVZH/PVZHS

8.1. Përmbajtje për Planin e Veprimit për Zhvendosje

Një Plan i Veprimit për Zhvendosje do të përfshijë sipas *Manualit për Përgatitjen e Planit të Veprimit për Zhvendosje* kapitujt dhe nënkapitujt e renditur më poshtë. Së bashku me strukturën kryesore shpjegohet përmbajtja e nevojshme në çdo kapitull.

Hyrje

- Përshkruani shkurtimisht projektin.
- Listoni komponentët e projektit duke përfshirë edhe objektet përcjellëse (nëse ka).
- Përshkruani komponentët e projektit që kërkojnë shpronësim dhe kompensim; japin vlerësime të përgjithshme të marrjes së tokës dhe zhvendosjes.

Minimizimi i Zhvendosjes

- Përshkruani përpjekjet e bëra për të minimizuar zhvendosjen.
- Përshkruani rezultatet e këtyre përpjekjeve.
- Përshkruani mekanizmat që përdorët për të minimizuar zhvendosjen gjatë zbatimit.

Census-i dhe Studimet Socio-Ekonomike

- Siguroni rezultatet e census-it të popullsisë, inventarët e pasurive, vlerësimet e burimeve natyrore, si dhe anketat socio-ekonomike.
- Identifikoni të gjitha kategoritë e ndikimeve dhe njerëzve të prekur.
- Përmbledhni konsultimet për rezultatet e anketave të ndryshme me personat e prekur.
- Përshkruani nevojën për përditësimet e census-it, inventarëve të aseteve, vlerësimet e burimeve, dhe anketat socio-ekonomike, nëse është e nevojshme, si pjesë e monitorimit dhe vlerësimit të PVZH-së.

Kuadri Ligjor

- Përshkruani të gjitha ligjet/zakonet vendase që zbatohen për zhvendosje.
- Identifikoni hapësirat midis ligjeve vendase dhe politikave të Grupit të Bankës Botërore, dhe përshkruani mekanizmat specifikë të projektit për të adresuar konfliktet.
- Përshkruani politikave të drejtës së pronësisë për secilën kategori të ndikimit dhe përcaktoni se zbatimi i zhvendosjes do të bazohet në dispozitat specifikë të PVZH-së për të cilat është rënë dakord.
- Përshkruani metodën e vlerësimit të përdorur për strukturat e prekura, toka, pemët, dhe pasuritë e tjera.
- Përgatitja e matricës së pronësisë.

Vendndodhjet e Zhvendosjes

- A i kërkon projekti vendndodhjet e zhvendosjes së komunitetit? A janë përfshirë njerëzit e ndikuar në një proces me pjesëmarrje për të identifikuar vendet, për të vlerësuar avantazhet dhe disavantazhet e secilit vend, dhe për të zgjedhur vendet e preferuara?
- A kanë qenë njerëzit e prekur të përfshirë në zhvillimin e një strategjie të pranueshme për zëvendësimin e strehimit? A do të ndërtohen/shpërndahen shtëpi të reja?
- A do të përfshijë projekti shpërndarjen e tokës bujqësore apo kullotave? A kanë qenë familjet, që do tu ndahen tokat, të përfshirë në identifikimin e vendeve të mundshme të reja, dhe a kanë pranuar në mënyrë eksplicite vendet e zgjedhura?
- Përshkruani procesin specifik të përfshirjes së popullsisë së prekur në identifikimin e vendeve të mundshme të banimit, duke vlerësuar avantazhet dhe disavantazhet, dhe duke bërë zgjedhjen e vendeve.

- Përshkruani studimet e fizibilitetit të kryera për të përcaktuar përshtatshmërinë e vendeve të propozuara, përfshirë vlerësimin e burimeve natyrore (toka dhe aftësinë e përdorimit të tokës, vegjetacionit dhe kapacitetin mbajtës blegtoral, anketat e burimeve të ujit) dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale të vendeve.
- Tregoni se cilësia e tokës dhe zona janë të përshtatshme për shpërndarjen e tokës bujqësore për të gjithë njerëzit me këtë. Paraqisni të dhëna për cilësinë e tokës dhe aftësitë e saj, potencialin prodhues, dhe sasinë.
- Jepni llogaritjet në lidhje me kërkesat e vendeve dhe disponueshmërinë.
- Përshkruani mekanizmat për: 1) prokurimin, 2) zhvillimin dhe 3) caktimin e tokës për zhvendosje, duke përfshirë dhënien e titullit, ose të drejtat e përdorimit të tokave të ndara.
- Jepni përshkrim të detajuar të marrëveshjeve për zhvillimin e vendit për bujqësi, duke përfshirë financimin e kostove të zhvillimit.
- A janë konsultuar komunitetet pritëse rreth PVZH? A kanë marrë pjesë në identifikimin e ndikimeve të mundshme në komunitetet e tyre, masat e duhura zbutëse, dhe përgatitjen e PVZH? A marrin komunitetet pritëse një pjesë të përfitimeve të zhvendosjes?

Zhvendosja e të Ardhurave

- A janë të drejtat e kompensimit të mjaftueshme për të rivendosur kategoritë e të ardhurave për secilën kategori të ndikimit? Çfarë masash të tjera rehabilituese ekonomike janë të nevojshme?
- Shkurtimisht përcaktoni strategjitë e restaurimit për secilën kategori të ndikimit dhe përshkruani aspektet e tyre institucionale, financiare dhe teknike.
- Përshkruani procesin e konsultimeve me popullsitë e prekura dhe pjesëmarrjen e tyre në finalizimin e strategjive për restaurimin e të ardhurave.
- Si ndryshojnë këto strategji në varësi të fushës së ndikimit?
- A kërkon restaurimi i të ardhurave ndryshimin e jetesës, zhvillimin e fermave bujqësore alternative ose disa aktivitete të tjera që kërkojnë një sasi të konsiderueshme të trajnimit, kohë për përgatitjen dhe zbatimin?
- Si do të trajtohen rreziqet e varfërimit?
- Cilat janë rreziqet kryesore institucionale dhe të tjera për zbatimin e qetë të programeve të zhvendosjes?
- Përshkruani procesin për monitorimin e efektivitetit të masave të restaurimit të ardhurave.
- Përshkruani ndonjë program të zhvillimit social apo komunitar që veprojnë aktualisht në ose rreth zonës së projektit. Nëse programet ekzistojnë, a i përmbushin ata prioritetet e zhvillimit të komunitetit të tyre të synuar? A ka mundësi për propozuesit e projektit për të mbështetur programe të reja ose zgjerimin e programeve ekzistuese për të përmbushur prioritetet e zhvillimit të komunitetit në zonën e projektit?

Rregullimet Institucionale

- Përshkruani institucionin(et) përgjegjës për ofrimin e secilit artikull/aktiviteti në politikën e pronësisë; zbatimin e programeve të restaurimit të të ardhurave; dhe koordinimin e aktiviteteve që lidhen me të dhe të përshkruara në planin e veprimit të zhvendosjes.
- Saktësoni se si do të trajtohen Çështjet e koordinimit në rastet kur zhvendosja është e shpërndarë në një numër të juridiksioneve apo kur zhvendosja do të zbatohet në faza gjatë një periudhe të gjatë kohore.
- Identifikoni agjencinë që do të koordinojë të gjitha agjencitë zbatuese. A do të ketë mandatin dhe burimet e nevojshme?

- Përshkruani institucionet e jashtme (jo projekt) të përfshira në procesin e restaurimit të të ardhurave (zhvillimin e tokës, ndarjen e tokës, kredi, trajnimi) dhe mekanizmat për të siguruar ecurinë e duhur të këtyre institucioneve.
- Diskutoni kapaciteteve institucionale dhe angazhimin për zhvendosje.
- Përshkruani mekanizma për të siguruar monitorim të pavarur, vlerësimin dhe auditimin financiar të PVZH-së dhe për të siguruar që masat korrigjuese janë kryer në kohën e duhur.

Plani Kohor i Zbatimit

- Lista e Hapave Kronologjike në zbatimin e PVZH-së, duke përfshirë identifikimin e agjencive përgjegjëse për çdo aktivitet dhe me një shpjegim të shkurtër për çdo aktivitet.
- Përgatitja e një plani zbatimi muaj-pas-muaji (për shembull duke përdorur grafikun Gant) të aktiviteteve që do të ndërmerren si pjesë e zbatimit të zhvendosjes.
- Përshkruani lidhjen midis Zbatimit të zhvendosjes dhe fillimit të punimeve civile për secilin nga komponentët e projektit.

Pjesëmarrja dhe Konsultimet

- Përshkruani aktorët e ndryshëm.
- Përshkruani procesin e promovimit të konsultimit/pjesëmarrjes së popullsisë së prekur dhe palëve të interesuara në përgatitjen dhe planifikimin e zhvendosjes.
- Përshkruani procesin e përfshirjes populatat e prekura dhe aktorë të tjerë në zbatimin dhe monitorimin.
- Përshkruani planin për shpërndarjen e informacionit të PVZH-së tek komuniteti i prekur dhe palët e interesuara, duke përfshirë informacion në lidhje me kompensimin për pasuritë e humbura, të drejtën për kompensim, ndihmën e zhvendosjes, dhe ankesave ndaj dëmshpërblimit.

Procesi i Ankimimit

- Përshkruani hap pas hapi procesin për regjistrimin dhe trajtimin e ankesave dhe ofroni detaje specifike në lidhje me një proces me kosto të lirë për ankesat e regjistrimit, kohën e përgjigjes, dhe mënyrat e komunikimit.
- Përshkruani mekanizmin për apelim.
- Përshkruani dispozitat për t'ju drejtuar gjykatave civile, nëse opsionet e tjera dështojnë.

Monitorimi dhe Vlerësimi

- Përshkruani procesin e monitorimit të brendshëm/të performancës.
- Përcaktoni treguesit kryesorë të monitorimit që rrjedhin nga sondazhi bazë. Siguroni një listë të treguesve të monitorimit që do të përdoren për monitorimin e brendshëm.
- Përshkruan marrëveshjet/rregullimet institucionale (duke përfshirë edhe ato financiare).
- Përshkruani shpeshhtësinë e raportimit dhe përmbajtjes për monitorimin e brendshëm.
- Përshkruani procesin për integrimin e feedback-ut nga monitorimi i brendshëm në zbatim.
- Përcaktoni metodologjinë për monitorimin e jashtëm.
- Përcaktoni treguesit kryesorë për monitorimin e jashtëm.
- Përshkruani shpeshhtësinë e raportimit dhe përmbajtjes për monitorim të jashtëm.
- Përshkruani procesin për integrimin e feedback-ut nga monitorimi i jashtëm në zbatim.
- Përshkruani masat për vlerësimin e jashtëm final.

Kostot dhe Buxheti

- Jepni një deklaratë të qartë të përgjegjesisë financiare dhe autoritetit përkatës.
- Listoni burimet e fondeve për zhvendosjen dhe përshkruani rrjedhën e fondeve.
- Sigurohuni që buxheti për zhvendosjen është i mjaftueshëm dhe përfshihet në buxhetin e përgjithshëm të projektit.
- Identifikoni kostot e zhvendosjes (nëse ka) që do të financohen nga qeveria dhe mekanizmat që do të krijohen për të siguruar koordinimin e disbursimeve me afatin kohor të PVZH-së dhe projektit.
- Përgatisni një buxhet të parashikuar, me kosto dhe me pika, për të gjitha shpenzimet e risistemimit, duke përfshirë planifikimin dhe zbatimin, menaxhimin dhe administrimin, monitorimin dhe vlerësimin, dhe të papriturat.
- Përshkruani mekanizma specifike për të rregulluar vlerësimet e kostos dhe pagesat e kompensimit më luhatjet e inflacionit dhe të monedhës.
- Përshkruani dispozitat që shpjegojnë ndryshimet e papritura fizike dhe të çmimit.
- Përshkruani marrëveshjet financiare për monitorim të jashtëm dhe vlerësim, duke përfshirë procesin e dhënies dhe mirëmbajtja e kontratave për të gjithë kohëzgjatjen e zhvendosjes.

Anekse

- Kopjet e census-it dhe instrumentet e anketës, formatet e intervistës, dhe çdo mjet tjetër kërkimor
- Informacion mbi të gjitha konsultimet publike, duke përfshirë njoftimet dhe oraret e takimeve publike, procesverbalet e mbledhjeve, dhe listat e pjesëmarrësve.
- Shembuj të formateve që do të përdoren në monitorimin dhe raportimin e zbatimit të PVZH.

8.2. Përmbajtje për Planin e Veprimit për Zhvendosje të Shkurtuar

Paraqitja e mëposhtme është një model për një PVZH të shkurtuar (PVZSHS):

1. Census/Studim i realizuar me personat e zhvendosur dhe vlerësimin e aktiveve;

(Lista e personave të prekur nga projekti dhe se si ata preken. Çfarë do të humbasin ata konkretisht dhe sa është vlerësimi?)

2. Përshkrim i kompensimit dhe asistencat e tjera të ofruara për zhvendosje;

(vetë-shpjeguese: çfarë po u jepet/ofrohet dhe si po ndihmohen)

3. Konsultime me personat e ndikuar nga projektin (PNP) rreth alternativave të pranueshme;

(raport mbi konsultimet)

4. Përgjegjësia institucionale për zbatimin e procedurave për përgjigjet/zgjidhjet e ankesave

(Kush bën çfarë? Dhe kur?)

5. Rregullimet për monitorim dhe zbatim

6. Afati Kohor dhe Buxheti

(koha dhe kostot për çdo hap/fazë)

7. Studimi i thjeshtë socio-ekonomik

(Përveç census-it të PNP-ve individualë, studimi do të listojë të gjitha pasuritë e tyre dhe faktorët e jetesës në mënyrë që të jetë në gjendje për të vlerësuar madhësinë e ndikimit.)

Është e rëndësishme të theksohet se në bazë të OP 4.12 "Për Zhvendosjen e Pavullnetshme", Aneksi A, neni 22³⁸ një plan i shkurtuar përfshin minimalisht elementet e mëposhtme:

- a. një studim census të personave të zhvendosur dhe vlerësimin e aseteve;
- b. përshkrimin e kompensimit dhe ndihmave të tjera të zhvendosjes që do të ofrohen;
- c. konsultimet me personat e zhvendosur rreth alternativave të pranueshme;
- d. përgjegjësia institucionale për zbatimin e procedurave për përgjigjet/zgjidhjet e ankesave;
- e. masat për monitorimin e zbatimit; dhe
- f. një afat kohor dhe buxheti.

³⁸ OP 4.12, Aneksi A:

[http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/PROJECTS/EXTPOLICIES/EXTOPMANUAL/0,,contentM
DK:20066696~menuPK:64701637~pagePK:64709096~piPK:64709108~theSitePK:502184,00.html](http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/PROJECTS/EXTPOLICIES/EXTOPMANUAL/0,,contentM
DK:20066696~menuPK:64701637~pagePK:64709096~piPK:64709108~theSitePK:502184,00.html)

Aneksi 9. Lidhja e Zhvendosjes me Aktivitetet Specifike të PIUED-it

Më poshtë është paraqitur një lidhje paraprake e aktiviteteve me procedurat e zhvendosjes është paraqitur më poshtë. Kjo tabelë dhe specifikimet në qoftë se do të ndërmerret një PVZH për secilin projekt janë subjekt i përditësimeve të mëtejshme.

Rajoni/Qyteti	Berat		Saranda	Gjirokastrë	Himara
Fazat përpara PVZH-it dhe Aktivitet PVZH-it	Rruga me kalldrëm për te kalaja "Mihal Kommeno"	Rruga automobilistike për te kalaja³⁹ "Muzak Topia"	Rehabilitimi i shkallëve të qendrës së qytetit	Ndriçimi i rrugës së qendrës së qytetit	Pajisjet e stacionit të transferimit të Himarës
Planifikimi i Projektit	✓	✓	✓	✓	✓
Fazat paraprake të përfshirjes së komuniteteve	✓	✓	✓	✓	✓
Regjistrimi i personave të prekur nga projekti dhe vlerësimi i aseteve.		✓			
Konsultimet me njerëzit që nuk janë prekur në fushën e aktivitetit / ose konsultim me PNP-të për alternativat e pranueshme	✓	✓	✓		
Përgatitja e PVZH-ve		✓			
Kompensimi/Zhvendosja		✓			
Aktivitetet e Post-PVZH		✓			

Pavarësisht zbatimit të aktiviteteve të projektit në Sarandë, Himarë, si dhe në "Muzak Topia", Berati dhe dy projektet e mbetura nuk do të ketë asnjë aktivitet apo politikë të blerjes së tokës dhe për këtë arsye nuk do të prodhohet asnjë PVZH.

Legjenda

Aktivitetet për këtë aktivitet zbatimi të projektit janë në versionin përfundimtar	Shkrimi Blu
Aktivitetet për këtë aktivitet zbatimi të projektit nuk janë në versionin përfundimtar	Shkrimi i Kuq
Aktiviteti që do të kryhet paraprakisht	✓

³⁹Nuk dihen akoma planet e detajuara dhe ekzaktesisht zona e prekur. Pas informacionit të plotë, angazhimi në aktivitetet e listuara të PVZH-së do të rifreskohet.

Aneksi 10. Procedurat në Kuadrin e Zbatimit të PVZH-së

10.1. Njoftimi, Procedurat e Vlerësimit dhe të Drejtat

Njoftimi i Blerjes së Tokës/Zhvendosjes

MZHU-ja nëpërmjet njoftimit publik që do të publikohet në gazetën ditore (për një muaj), do të informojë publikun për qëllimin e saj në blerjen e tokës për aktivitetet e projektit që do të zbatohen në kuadër të projektit. Një kopje e një njoftimi të tillë do të shërbejë çdo pronari, banori dhe personi ose agjenti që kanë një interes nga kjo tokë. Emrat dhe adresat e pronarëve, banorëve dhe agjentëve do të jenë lehtësisht të verifikueshme.

Njoftimi duhet të përcaktojë qartë informacionin e përmendur më poshtë:

- Propozimin e qeverisë për të blerë tokën;
- Qëllimin publik për të cilin kërkohet toka;
- Që propozimi ose plani mund të inspektohet te MZHU-ja ose në Zyrën e NJQV-ve/Njesisë së FSHZH-së së Projektit gjatë orarit të punës;
- Që çdo person i prekur mundet, me anë të një njoftimi me shkrim, të kundërshtojë transaksionin e shpronësimit, marrjes së tokës apo zhvendosjes duke dhënë arsyet për këtë veprim

Mekanizmat e Mundshme të Vlerësimit

Kompensimi i Përgjithshëm Financiar (në Para në dorë)

Metoda e kompensimit, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për t'u zbatuar për këtë procedurë të shpronësimit është kompensim në të holla. Opsioni "tokë për tokë" nuk është dhënë nga legjislacioni shqiptar⁴⁰ për pronarët privatë. Kompensimi në para duhet të jetë plotësisht i mjaftueshëm për të kompensuar të tokën/pronën e marrë dhe do të marrë në konsideratë disa kriterë kryesore:

- Përqindjet e kompensimit do të llogariten në konsultim me përfaqësuesit e popullsisë të ndikuara për të siguruar që përqindjet janë të drejta dhe të përshtatshme;
- Kompensimi për tokën do të jetë i mjaftueshëm për ti mundësuar personave të ndikuar të rivendosin standardin e tyre të jetesës, pas zhvendosjes;
- Të gjitha kompensimet do të përfshihen në PVZH. Në rast të ndonjë ngjarjeje, pas kohës së përgatitjes së PVZH-it, kjo duhet të mbulojë koston e plotë të zëvendësimit *ekskluzive të amortizimit* dhe përfshirëse e të gjitha taksave të tilla si lejet e ndërtimit dhe pagesat titullin dhe kostove të punës;
- Pagesat e kompensimit duhet të bëhen përpara përvetësimit të aseteve ose para se të ndodh Zhvendosja fizike, për ti mundësuar personave të ndikuar që të fillojnë përgatitjen e zonave të reja të banimit;
- Kompensimi për infrastrukturën e shkatërruar ose shërbimet e ndërprera duhet tu paguhet

⁴⁰ Ivetmi rast kur mund të aplikohet kompensimi "tokë për tokë", është kur njësi ekonomike e prekur është vetë komuna dhe një pronë komunale është duke u shpronësuar. Këshilli i Ministrave i jep një tjetër pronë në kompensim të komunës së prekur. Në çdo rast tjetër, sipas parimit themelor, për shpronësimin i jepet një kompensim i drejtë (parim kushtetues) në të holla dhe jo në natyrë. Megjithatë, kjo është një praktikë e cila nuk është zbatuar ende nga Qeveria Shqiptare.

komuniteteve të ndikuara, apo institucioneve vendore, si të jetë e përshtatshme, me kosto të plotë zëvendësimi, para se të fillojnë punimet civile;

- Kompensimi për të ardhurat e humbura duhet tu paguhet pronarëve dhe të punësuarve për kohëzgjatjen e ndalimeve të punës që rezultojnë nga Zhvendosja e bizneseve.

Kompensimi i Tokës: Metoda e vlerësimit për të matur vlerën e kompensimit do të marrë në konsideratë të gjitha burimet e disponueshme të informacionit në mënyrë që vlera e propozuar për kompensimin të reflektojë vlerën e tregut / vlerën e zëvendësimit të tokës. Supozimet kryesore që duhet të merren në konsideratë në kuadrin e metodologjisë do të mund të lidhen me kuadrin aktual rregullator për shpronësimin e tokës dhe ndryshimet e tij të kohëve të fundit; analiza financiare mbi rrjedhjen e të ardhurave neto mbi vendet dhe lagjet e tyre; transaksionet eventuale (shitjet dhe leasing) në rajon. Më poshtë mund të gjeni një tabelat e përgjithshme ndihmëse që do të përdoren në fazën e kompensimit.

Tabela 1. Tabela model e llogaritjes së çmimeve për kompensimin financiar të tokës

Nr.	Komuna/Bashkia	Çmimi Min. (ALL/m ²)	Çmimi Max. (ALL/m ²)	Çmimi Mesatar (ALL/m ²)
1.	Çmimet për tokat bujqësore sipas listë së çmimeve të Qeverisë Shqiptare ⁴¹			
2.	Çmimet për shpronësimin e mëparshëm të tokës			
3.	Çmimet për tokat bujqësore sipas listës së çmimeve në transaksionet informale në zonë			
	Çmimi paraprak i rekomanduar për zonën e shpronësuar			

Kompensimi për Kulturat Bujqësore dhe Pemët: Metoda e vlerësimit për të përcaktuar këtë kompensim bazohet në Udhëzimin Nr. 1, Datë 10.05.2000, “Për kriteret teknike të përlllogaritjes së vlerës së bimëve drufrutore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes”.⁴² Kriteret teknike në këtë udhëzim përdoren vetëm nëse nuk ka indikatorë të transaksioneve të deklaruar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP).

Sipas destinacionit bimët drufrutore janë:

⁴¹Sipas VKM 514, Datë 31.07.2014 "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë " Buletini Zyrtar Nr.118, Viti 2014. http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/118-2014.pdf (faqe 3-150) Ky dokument ndryshon çdo vit përmes një VKM-je dhe është lëshuar në Gazetën/ Buletinin Zyrtar

⁴²Udhëzimi Nr. 1, datë 10.05.2000, “Për kriteret teknike të përlllogaritjes së vlerës së bimëve drufrutore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes”, <http://www.qbz.gov.al/doc.jsp?doc=docs/Udhezim%20Nr%201%20Dat%C3%AB%2005-10-2000.htm>

- Bimët drufrutore të kultivuara për prodhimin e frutave të tyre;
- Bimët drufrutore “mëmë” që kultivohen për të marrë materiale shumëzimi për shtimin e tyre.
- Bimë drufrutore me vlerë gjenetike e të regjistruara si të tilla në Bankën Gjenetike pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve ose dhe në Institutin e Pemëtarisë;
- Bimë drufrutore që kultivohen me qëllim prodhimin e frutave të tyre dhe për rregullimin e mjedisit banues ose/dhe biznesit;
- Fidanishtet me të gjitha strukturat e prodhimit dhe materialet mbjellëse dhe të shumimit të bimëve drufrutore.

Përlllogaritjet e vlerave të druve frutorë dhe kulturave të tjera sipas metodës së “kostove të zëvendësimit” për investimet dhe kostot faktike të aktivitetit, duke marrë parasysh vlerat e kostos së punës, pajisjeve dhe materialeve në kohën e vlerësimit. Një tabelë model për të vënë në dukje vlerësimin e pemëve dhe bimëve është paraqitur më poshtë.

Tabela 2. Tabela për Çmimet e Përdorura për të Kompensuar Humbjen e pemëve

Lloji i pemë bimore/Mosha	Mosha e Pemës/Viti i Prodhimit të Bimës			Humbjet shtesë	Totali
	E re/Vogël	Mesatare	E madhe		
Pema e portokallit					
Pema e limonit					
Ulliri, ... etj.					

Banka Botërore zbaton gjithashtu edhe metodën e "Kostos së Zëvendësimit" të vlerësimit të aseteve, e cila ndihmon për përcaktimin e shumës së mjaftueshme financiare për të zëvendësuar asetet e humbura dhe për të mbuluar kostot e transaksionit. Ajo çfarë dallon në teknikat e sipërpërmendura është se Banka Botërore përdor çmimet aktuale të tregut të bimëve dhe të prodhimit për një zëvendësim të drejtë dhe nuk marrin parasysh amortizimin e strukturave dhe të aseteve⁴³. Për të korrat vlera e parashikuar do të llogaritet në bazë të çmimit të pritur dhe çmimit njësi të tregut, duke pasur parasysh edhe koston e investimit për fillimin, përdorimin e tokës, përmirësimin e tokës etj. Në përgjithësi, vlera e pemëve të humbura është kostoja e zëvendësimit të trung-rrënjëve / filizave, përgatitjes së tokës dhe prodhimit të humbur nga pema në bazë të moshës së pemës dhe jetës produktive gjatë kohës që i duhet filizit të ri për tu maturuar dhe për të arritur një nivel të prodhimit të barabartë me pemën e humbur. Një vlerësim i ngjashëm do të bëhet për të korrat.

Procedurat për pagesën e kompensimit

Pagesat e kompensimit do të bëhen përpara ndodhjes së çdo përdorimi të tokës, humbjeje të aseteve, ose zhvendosjeje fizike të projektit, veç në mos këto pagesa janë stivosur për ti mundësuar personave të prekur fillimin e përgatitjes të vendeve të reja. Përgjegjësia e përgjithshme për pagesat mbi kërkesat e shpronësimit për projektin i takon Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për lëshimin e vendimit shpronësues dhe autorizimin e fondeve të nevojshme. Transferimi i marrjes së tokës duhet të përfundojë plotësisht, dhe bëhet pagesa duhet bërë para se ndonjë Punim mund të ekzekutohet në pronën

⁴³OP 4.12 - Involuntary Resettlement, Masat e Kërkuara, Dhjetor2001 (Rishikuar Prill 2003)

e shpronësuar. Çdo PNP do të marri kompensim të pagueshëm në një llogari bankare të hapur nga pronari për qëllimet e shpronësimit. Shuma të tilla do të miratohen nga një VKM dhe fondet do të kalojnë në llogarinë bankare të çdo PNP-je, sipas dokumentacionit bankar të ofruara nga ana e tyre. PNP-të do të informohen në mënyrë individuale nga banka jo më vonë se transferimi i kompensimit në llogari. Çdo kosto që lidhet me hapjen dhe mirëmbajtjen e llogarisë do të mbulohet nga Ministria dhe shërbimi bankar do të ofrohet falas për çdo PNP. Transferimi i pagesës do të bëhet pas publikimit në Fletoren Zyrtare të vendimit të shpronësimit. Vendimi i Këshillit të Ministrave për shpronësimin është efektiv (hyn në fuqi) menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare. Në rast të apelimit në Gjykatë, kur nuk arrihet asnjë marrëveshje, në qoftë se kompensimi që duhet paguar nuk është rënë dakord midis qeverisë dhe pronarit të tokës, një kompensim i tillë do të përcaktohet nga Gjykata. Në këto kushte personi i merr paratë nga banka, por në varësi të vendimit gjyqësor ka të drejtë të marrë një përfitim shtesë.

10.2. Implikimet Buxhetore dhe Financimi

Në përgjithësi, barra e koston së kompensimit do të mbulohet nga agjencitë ekzekutuese të tilla si ministritë qeveritare, OJQ-të dhe ofruesit e shërbimeve private, siç mund të jetë më e përshtatshme. Shpenzimet për zbatimin e PVZH përfshijnë tri kategori kryesore: (a) mbështetje teknike, (b) procedurat e shpronësimit, dhe (c) përvetësimi i tokës.

- a) *Asistenca teknike* për zbatimin e PVZH nënkupton monitorimin dhe përgatitjen e dosjes së aplikimit për shpronësim. Për zbatimin e këtyre projekteve do të përdoren fondet e kredisë së Bankës Botërore për të mbuluar kostot e asistencës teknike.
- b) E gjithë përgjegjësia për zhvendosjen dhe shpronësimin për Projektin është në varësi të Këshillit të Ministrave. Përgjegjësia financiare për procedurat e shpronësimit, duke përfshirë pagesën e kompensimit, shpenzimet për zhvendosje etj, është nën Ministrinë e Zhvillimit Urban. Shpenzimet për procedurat e shpronësimit janë të mbuluara nga buxheti i MZHU-së për funksionimin e komisionit të veçantë të shpronësimit dhe për mbulimin e shpenzimeve të çdo tarife për regjistrimin e titujve të rinj të pronësisë dhe lëshimin e Certifikatave të Pronësisë për të gjithë PNP-të.
- c) *Përvetësimi i tokës* do të financohet nga buxheti i Qeverisë së Shqipërisë. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për lëshimin e vendimit të shpronësimit dhe autorizimin e fondeve të kërkuara, të cilat do ti dorëzohen pronarëve sapo vendimi i Këshillit të Ministrave të publikohet në Fletoren Zyrtare. Transferimi i tokës së blerë duhet të përfundojë plotësisht, dhe pagesat duhet të bëhen, para fillimit të punimeve në pronat e shpronësuar.

Vlerësimi i koston së përgjithshme të zhvendosjes dhe kompensimit do të përcaktohet gjatë studimit socio-ekonomik. Disbursimet në bazë të kërkesave buxhetore, të përcaktuara nga PVZH-et në konsultim me PNP-të dhe krerët lokalë, do të bëhet nëpërmjet administratës përkatëse të Qarkut.

Aneks 11. Rregullimet Institucionale për Zbatimin e Zhvendosjes dhe /ose Procedurës së Marrjes së Tokës

Hapa	Institucioni	Përshkrimi I përgjegjësi	Koha	Vërejtje
Planifikimi i PVZH				
Hapi I	FSHZH (ose Konsulent në emër të FSHZH-së)	Identifikimi i PNP-ve, informacion publik, përlllogaritja e vlerës së PVZH		Informacion mbi ndikimet e projektit, nevojat e PVZH, vlerësimi dhe verifikimi i PNP-ve
Hapi II	Njësia e mjedisit e FSHZH-së (ose Konsulent në emër të FSHZH-së)	Konsultimi me PNP-të		Shpjegim mbi aktivet që do të preken, identifikimi i mënyrës më të mirë për kompensim, shpjegimi i kohës së kompensimit, aktorët kryesorë në procesin e zbatimit, procedurat që duhet të ndërmerren dhe të drejtat për Ankimim.
Hapi III	Njësia e mjedisit e FSHZH-së (ose Konsulent në emër të FSHZH-së)	Përgatitja e raportit përfundimtar të PVZH		Përgatitja e raportit përfundimtar të PVZH duke marrë parasysh komentet e MZHU dhe BB
Hapi IV	Njësia e mjedisit e FSHZH-së, BB, MZHU-ja	Dorëzimi i PVZH te Grupi I Punës I BB për shqyrtim dhe pa kundërshtim para zbatimit. Miratimi i raportit përfundimtar		Asnjë kundërshtim nga ekspertët e Bankës Botërore për PVZH-në. Formalizmi I raportit të PVZH dhe përfshirja te Termat e Referencës së zbatimit të projektit.
Hapi V	Njësia e mjedisit e FSHZH-së (ose Konsulent në emër të FSHZH-së)	Krijimi i Komitetit të Ankimimeve		Komiteti i Ankimimeve duhet që të formalizohet dhe kontaktet e veçanta duhet t’ju jepen PNP-ve
Zbatimi I PVZH				
Hapi VI	FSHZH MZHU	Kërkesë për shpronësim për interes publik	Për tu vendosur	Plotësimi i kriterëve të parashikuara me ligj, veçanërisht dokumentet e nevojshme që provojnë nevojat e shpronësimit
Hapi VII	MZHU	Komisioni i Shpronësimeve të MZHU duhet të shqyrtojë kërkesën dhe dokumentet	Për tu vendosur	Ngritja e Komisionit të Shpronësimit, verifikimi i dokumentacionit mbi pronat, llogaritja dhe verifikimi i vlerës së kompensimit
		Nëse kushtet ligjore plotësohen MZHU fillon procesin e shpronësimit		
		Nëse jo, kërkesa do të refuzohet		
Hapi VIII	FSHZH , Komiteti i Ankimimeve	Të sigurojë që vendimet e Komisionit të Shpronësimit janë të bazuara në legjislacionin shqiptar dhe udhëzimet e BB dhe marrin parasysh kërkesat e PNP-ve.	Për tu vendosur	Vlerësimi i Përputhshmërisë midis kërkesave të palëve të interesuara

Hapi IX	Local Authority/ MZHU /PAPs	Të ndërtohet marrëveshja duke marrë parasysh kërkesat e çdo pale dhe legjislacionin	Për tu vendosur	Ofrimi i zgjidhjeve dhe marrëveshjeve që mbështesin kërkesat e PNP-ve sipas ligjit
Hapi X	MZHU	Marrëveshja me PNP-të për shpronësimet	Për tu vendosur	E rëndësishme: Vlerësimi i drejtë i pronave
		Publikimi i njoftimit për shpronësim - Shpallja		Procedura duhet të ndiqet me kujdes dhe të respektohet e drejta e personave të tretë për të parandaluar ankimimin në Gjykatë
		Shqyrtimi i sugjerimeve dhe ankesave të personave të ndikuar nga procesi		Shpronësimi do të bëhet për personat do të pranojnë me vullnet të lirë për t'u kompensuar me kushtet e publikuara.
		Përgatitja e Projekt - Vendimit të Këshillit të Ministrave		Përgatitja e VKM-së dhe kompensimit të PNP
Hapi XI	Këshilli i Ministrave	Të miratojë vendimin e shpronësimet për interes publik;	Për tu vendosur	VKM do të zbatohet 1 muaj pasi botimit në fletoren zyrtare
		por		
		Hedh poshtë propozimin e MZHU-së me sugjerimin për ta rishikuar, nëse nuk është në përputhje me ligjin. I paguan kompensimin personave të ndikuar nga projekti.		
Hapi XII	FSHZH (ose Konsulent në të FSHZH-së)/ Komiteti i Ankimimeve	Asistencë në marrëdhënien mes PNP-ve dhe autoriteteve lokale dhe qeveritare, verifikimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të PVZH	Për tu vendosur	Verifikimi i përputhshmërisë së marrëveshjes në mes palëve të interesuara.
Hapi XIII	FSHZH (ose Konsulent në emër të FSHZH-së)/ Komiteti i Ankimimeve	Nëse është e nevojshme, mbështetje ndaj PNP-ve mbi procedurat e ankesave për organet administrative, procedurat e PVZH, vlera e kompensimit etj dhe mbështetje për ankesat e PNP-ve në Gjykatë	Për tu vendosur	Nëse PNP-të do të kenë ankesa.
Hapi XIV	PNP	Hapja e një llogarie bankare dhe raportimi në MZHU	Për tu vendosur	Mbështetje institucionale në procesin e kompensimit
Hapi XV	MZHU	Të kryejë pagesën e kompensimit personave të ndikuar nga shpronësimi përpara se puna civile të fillojë	Për tu vendosur	Të sigurohet që kompensimi është bërë sipas (shumën dhe kohën) marrëveshjes së nënshkruar nga palët e interesuara dhe para fillimit të zbatimit të projektit

Hapi XVI	FSHZH (ose Konsulent në emër të FSHZH-së)	Të sigurojë që zbatimi i procesit ka marrë parasysh të gjitha pretendimet e paleve të interesuara	Për tu vendosur	Të sigurohet që kompensimi është bërë sipas (shumën dhe kohën) marrëveshjes së nënshkruar nga palët e interesuara.
Hapi XVII	FSHZH	Përgatitja e raportit përfundimtar për zbatimin e PVZH	Për tu vendosur	Duke pasur parasysh se kompensimet duhet të përfundojnë përpara fillimit të zbatimit të projektit
Hapi XVIII	MZHU, PNP, FSHZH	Caktimi i procesit të publikimit sipas kërkesave të interesuara dhe në lidhje me VKM	Për tu vendosur	Të sigurojë një dokument të nënshkruar që tregon se PVZH është përfunduar dhe kompensimet janë kryer.
			Për tu vendosur	Ky dokument gjithashtu do të verifikojë në të ardhmen që tokat e shpronësuara janë pronësi e MZHU-së

Aneks 12. Konsultimi Publik për KMMS-në – Minutat e Takimit

Republika e Shqipërisë
Ministria e Zhvillimit Urban
Fondi Shqiptar i Zhvillimit

FSHZH, dt.06 / 07/ 2016

KONSULTIM ME PUBLIKUN PER KRITERET MJEDISORE DHE SOCIALE TE PROJEKTIT “PER ZHVILLIM TE INTEGRUAR URBAN DHE EKONOMIK”

Projekti “Per zhvillim te integruar urban dhe ekonomik”, i financuar nga Banka Boterore, pritet te zbatohet nga Qeveria Shqiptare (Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Finances, Fondi Shqiptar i Zhvillimit” pas miratimit te tij.

Ne konsultimin me publikun u diskutuan rezultatet e pritshme te ketij projekti, vecanerisht ne lidhje me aspektet mjedisore dhe sociale, permes prezantimit te Kuadrit te Menaxhimit Mjedisor dhe Social (Draft). Ne kete takim gjithashtu u prezantuan dy Plane Menaxhimi Sociale dhe Mjedisore per dy nenprojekte: “Rehabilitimi i Shkallareve te Sarandes” dhe “Rehabilitimi i rruges me kalldrem Mihal Komneno per ne Kalane e Beratit dhe pikes panoramike Tabja”, Draft.

Dokumentat jane ngarkuar ne faqen zyrtare te Fondit Shqiptar te Zhvillimit, te Ministrise se Zhvillimit Urban dhe te ndara permes mediave sociale (Facebook).

http://www.albaniandf.org/english/publikime/Pages/Publikime_te_tjera.html

<https://www.facebook.com/albaniandf/>

Konsultimi me publikun u organizua ne Fondin Shqiptar te Zhvillimit, ne 6 Korrik, 2016, ora 09:30.

Pjesemarresit ne takim ishin perfaqesues te:

Ministrive të Linjes (MZHU, ME, MM, MPS)

OJF

Banka Boterore

(Lista e pjesemarrësve në fund të këtij dokumenti)

Informimi i publikut

Pjesemarrësit u informuan në lidhje me:

- Vendndodhjen e projektit
- Llojin e nderhyrjeve të parashikuara gjatë projektit
- Permbledhje të Kuadrit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social
- Ndikimet mjedisore dhe sociale të nenprojektit
- Masat zbutëse mjedisore dhe sociale të nenprojektit

Permbledhje e komenteve dhe rekomandimeve të pjesemarrësve

Takimi u hap nga Z. Nertil Jole, përfaqësues i MZHU, i cili prezantoi projektin në përgjithësi dhe komponentet kryesore të tij.

Znj. Anni Kallfa, Përgjegjëse e Njesisë së Mjedisit pranë FSHZH, prezantoi në detaje komponentet mjedisore dhe sociale të projektit, ndikimet e pritshme dhe masat zbutëse të rekomanduara. Ajo bëri një prezantim të instrumenteve ligjore ku do të bazohet projekti, përfshirë Marrëveshjen e Kredës që do të firmoset midis Bankës Boterore dhe Qeverisë Shqiptare dhe do të shërbejë si baza kryesore e referencës ligjore. Prezantimi gjithashtu u fokusua në çështjet e shpronësimit dhe procedurat përkatëse, në rast nevojë gjatë zbatimit të nenprojekteve.

Pas prezantimit pati disa pyetje nga pjesemarrësit, si më poshtë:

1. Pyetje. Znj. Sabina Cenameri, specialiste në Ministrinë e Mjedisit.

Cila është kohezgjatja e zbatimit të projektit dhe kur pritet të fillojnë punimet?

Pergjigje. Z. Nertil Jole, MZHU

Punimet pritet te fillojne pas miratimit te marreveshjes se kredise ose afersisht ne fillim te vitit 2017 dhe do te vazhdojne per 5 vjet.

2. Pyetje: Z. Pal Coku, specialist mjedisi prane FSHZH

A pritet qe qeverisja lokale te kontribuojne me ndonje perqindje ne investim? Kush do ta mbuloje koston e shpronesimeve gjate zbatimit te projektit?

Pergjigje: Z. Blendi Bushati, Drejtorise i Departamentit te Zhvillimit Rajonal, FSHZH: Bashkite nuk do te kontribuojne ne investim pasi projekti do te financohet nga Banka Boterore. Ne lidhje me shpronesimet qe mund te dalin gjate projektimit dhe zbatimit, ato do te mbulohen nga Qeveria Shqiptare.

3. Pyetje: Znj.. Sabina Cenameri, Si do te kryhet mirembajtja pas perfundimit te punimeve?

Pergjigje: Z. Blendi Bushat: Perpara fillimit te zbatimit te projektit. FSHZH do te firmose marreveshje mirembajtjeje me bashkite perfituese. Ne kete marreveshje, e cila hyn ne fuqi menjhere pas periudhes se garancise, projekti do te transferohet ne NJQV perkatese, e cila do te perballoje koston e mirembajtjes.

FOTODOKUMENTIM



LISTA E PJESEMARRESVE

LISTA E PIESEMARRJESVE NE KONSULTIMIN ME PUBLIKUN NE LIDHJE ME PROJEKTIN "PER ZHVILLIM TE INTEGROUAR URBAN DHE EKONOMIK"
 ASPEKTEI MJEDISORE DHE SOCIALE (KUADRI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL, PLANET E MENAXHIMIT MJEDISORE DHE SOCIALE)

LIST OF PARTICIPANTS IN THE CONSULTATION MEETING FOR "PROJECT FOR INTEGRATED URBAN ECONOMIC DEVELOPMENT"

Tirane, 06. 07.2016

FSHZH/ADF

Emri/mbiemri Name	Institucioni Institution	pozicioni Position	Kontakti Contact	Firma Signature
1. Shute Shabe	Prande Botora	Special. Prune	shute@korelbank.org	
2. Bledi Bushuki	RSHT UH	Dr. Zhurnal	bledi@albiniq.org	
3. Ardian Mazi	MZHEFTS	Drejtor i Pergj.	ardian.mazi@ekonomia.gov.al	
4. DENIS THEMELI	FSHZH	ARTISTE UJ.H.T	dhenelli@albanianfd.org	
5. Pal Selca	F.SH.ZH	Ekspert mjedior	pal@ceks65.org	
6. HARRIDA CIL	F.SH.ZH	NGJERA MBSHIT TEBULICE	harrida@albanianfd.org	
7. Genti Gjeji	F.SH.ZH	Mou i Gjejt.	genti_723@yca.org	
8. Anila Morina	M.ZH.U	Pengjegjese	anila.morina@zhvillimurban.com	

9.	NR300 LCUE	E.SH.ZH.	Kopje e hyrjes	okre.al/lanime.dj.org	
10.	Olivia Kolaçku	FSHZH	DZAR	okre.al/lanime.dj.org	
11.	500 Shprehimes	MUSR Specialiste	077758	meqshprehimesocial.gov.al	
12.	Sabina Cenameri	Ministria e Tregëtisë	Specialiste	sabina.cenameri@meq.gov.al	
13.	ALI COKA	BIOPANT ALBANIA	OTF	biopantalbania.org.al	
14.					
15.					
16.					
17.					
18.					
19.					
20.					
21.					
22.					
23.					

Aneksi 13. Indikatorët e Propozuar të Planit të Monitorimit Social⁴⁴

Nr	Çështje/Aktivitetet për Monitorim	Indikatorë
1	Suksesi/pranueshmëria e përgjithshme e kompensimit/zhvendosjes si proces	<p>Kompensime/kontrata individuale të zhvendosjes (panëshkruara) si përqindje e kompensimit totalit / kontratave të risistemimit</p> <p>Raporti i PNP-ve mbështetës të projektit përkundrejt atyre që nuk e mbështesin</p> <p>Niveli i konsultimit publik i matur si raport i atyre që pranojnë se kanë qenë pjesë</p> <p>Individë të konsultuar dhe jo të konsultuar. Ky raport mund të përcaktohet nga marrja e mostrave të rastit.</p> <p>Koha faktike e përfundimit të zhvendosjes në krahasim me kohën e planifikuar</p>
2	Pranueshmëria ose e projektit nga komuniteti	<p>Nr i ankesave si përqindje ndaj totalit të PNP-ve</p> <p>Nr. i ankimeve të zgjidhura me sukses si përqindje ndaj totalit të ankimeve</p>
3	Pranueshmëria ose e PNP-ve nga komuniteti pritës	Nr i konflikteve midis PNP-ve dhe komunitetit pritës
4	Restaurimi i zonave të shpëputura përkohësisht si pasojë e ndërtimeve	Sipërfaqja e tokës e rregulluar përsëri për kultivim si përqindje e totalit të tokës së përdorur
5	Zëvendësimi i tokës për kullotje e zhvendosur në mënyrë të përhershme nga rrugët dhe ndërtesat për ndërtim	Sipërfaqe e re e tokës e hapur për kultivim/kullotje si përqindje e sipërfaqes totale origjinale të kultivuar/për kullotje.
6	Cilësia e jetesës në krahasim me periudhën përpara zhvendosjes/kompensimit	<p>Numri i shtëpive të mëdha dhe të cilësive më të mira të ofruara si përqindje e numrit të përgjithshëm të shtëpive në vendbanimin origjinal</p> <p>Numri i individëve dhe familjeve në gjendje për të rivendosur aktivitete e para-zhvendosje, toka dhe kultura apo të ardhura të tjera alternative, si përqindje e totalit të PNP-ve</p> <p>Të ardhurat para-projektit të individëve/grupeve vulnerabël të prekur kundrejt të ardhurave të tyre aktuale</p> <p>Numri i personave që marrin pjesë në aktivitetet e projektit në krahasim me totalin e PNP-ve</p> <p>Prirjet në sëmundje mjedisore të tilla si diarre, kollitjet etj.</p> <p>Prirjet në sëmundjet e frymëmarrjes</p> <p>Prirjet në statistikat e HIV/AIDS në krahasim me statistikat përpara zhvendosjes/zhvendosjes</p> <p>Normat e vdekshmërisë pas zhvendosjes/zhvendosjes në krahasim me normat e para zhvendosjes/zhvendosjes</p> <p>Numri i PNP-ve me akses në ujë të pijshëm krahasuar me totalin e PNP</p>
7	Produktiviteti	Prodhimi i para-projektit kundrejt prodhimit aktual (kulture për kulture, tokë për tokë).

⁴⁴Shënim: Këto janë vetëm disa nga treguesit që do të përdoren. Treguesit specifikë do të duhet të zhvillohen duke marrë parasysh kushtet specifike të vendeve.

	<p>Prodhimi pas zbatimit të projekti për familje të prekur/fermë-shtëpi në krahasim me të ardhurat para-projektit.</p> <p>Ruajtja e jetës së egër dhe aktivitetit eko-turistik në tokën e fituar sipas planit</p>
--	---